



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister



STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM 2016-2021 (SKZH)

**Prishtinë,
Janar, 2016**

PËRMBAJTJA

Vizioni	4
Pse kapitali njerëzor?	11
Ndërhyrja e SKZH.....	11
1. Gjithëpërfshirja në arsimin parashkollor dhe parafillor	12
2. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin parauniversitar	13
3. Ndërlidhja më e mirë ndërmjet sistemit arsimor dhe tregut të punës.....	14
4. Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor	15
5. Optimizimi i shpenzimeve në arsim nëpërmjet sistemeve të të dhënave	16
6. Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës.....	17
7. Adresimi i punësimit joformal dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për punë	18
Pse qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit?	20
Ndërhyrja e SKZH.....	20
8. Përmirësimi i mëturjeshtëm i ofrimit të shërbimeve për bizneset dhe qytetarët.....	21
9. Zvogëlimi i pengesave administrative për licencat dhe lejet.....	22
10. Përmirësimi i efikasitetit të sistemit të inspektimeve	23
11. Miratimi i politikave të bazuara në të dhëna.....	24
12. Mbyllja e hapësirave për abuzime në sistemin e prokurimit publik.....	25
13. Forcimi i sistemit të të drejtave pronësore.....	26
14. Rritja e efikasitetit të gjyqësorit në zgjidhjen e rasteve.....	27
15. Lufta kundër informalitetit përmes krijimit të një agjencie të vetme për mbledhjen e të hyrave	28
Pse industritë konkurruese?	30
Ndërhyrja e SKZH.....	30
16. Rritja e qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare.....	31
17. Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara	32
18. Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar	33
19. Promovimi i investimeve të huaja direkte (IHD) dhe rritja e rolit të diasporës në zhvillimin ekonomik	34
20. Rregullimi i tokave bujqësore.....	35
21. Shfrytëzimi i potencialit mineral të Kosovës.....	36
22. Ristrukturimi dhe rivitalizimi i Trepçës.....	37
23. Zhblllokimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për zhvillim	38
24. Qeverisja e mirë dhe performanca e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore.....	39
Pse infrastruktura?	41
Ndërhyrja e SKZH.....	41
25. Ndërtimi i kapaciteteve të reja energjetike dhe energjia e qëndrueshme	42
26. Krijimi i një tregu të hapur dhe konkurrues të energjisë elektrike	43
27. Ulja e konsumit të energjisë përmes masave të efikasitetit	44
28. Shfrytëzimi racional i burimeve të ripërtërishme të energjisë.....	45
29. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore.....	46
30. Shtirja e infrastrukturës së teknologjisë informative.....	47
31. Infrastruktura bujqësore në funksion të agro-biznesit	48
32. Shfrytëzimi racional dhe rritja e kapacitetit të burimeve ujore	49
33. Shfrytëzimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	50

34. Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave	51
Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim	52
1) Planifikimi i veprimeve	52
2) Lidhja me kornizat tjera të planifikimit strategjik.....	53
3) Zotimi i burimeve.....	53
4) Përforcimi i kapaciteteve.....	54
5) Monitorimi i progresit	55
6) Vlerësimi i rezultateve.....	55

VIZIONI

PSE DHE ÇFARË ËSHTË STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM?

Republika e Kosovës ndodhet në një fazë të rëndësishme kur duhet të orientohet agjenda zhvillimore drejt integritimeve evropiane në të gjitha fushat. Një orientim i tillë zhvillimor evropian vjen natyrshëm pas tejkalimit të fazës së emergjencës dhe stabilizimit gjatë viteve 1999-2007, dhe fazës së shtet ndërtimit në periudhën pas shpalljes së pavarësisë. Gjatë fazës së emergjencës dhe stabilizimit, ne si shoqëri bashkë me partnerët tanë ndërkombëtarë u përqendruam në rindërtimin e infrastrukturës elementare të shkatërruar si dhe në krijimin e kushteve normale për jetesë. Më pas, në fazën e shtet ndërtimit, energjitë tona u orientuan drejt ndërtimit të arkitekturës institucionale të shtetit si dhe infrastrukturës elementare fizike për zhvillim dhe mirëqenie. Kështu, investimet publike u orientuan drejt krijimit të institucioneve të reja shtetërore, zhvillimit të infrastrukturës arsimore dhe shëndetësore, si dhe infrastrukturës tjetër të nevojshme për zhvillim të qëndrueshëm.

Ndërkohë që normat e rritjes ekonomike gjatë viteve të fundit ishin modeste marrë parasysh, ndër të tjera, krizën botërore ekonomike – mesatarisht 3.3% në vit prej vitit 2009 – dhe patën efekt në uljen e nivelit të varfërisë së përgjithshme, ato kanë mundësi që të jenë edhe më të larta. Në fakt, ato duhet të jenë më të larta për t'i mundësuar Kosovës zhvillim të qëndrueshëm dhe arritje të standardeve më të larta të jetesës. Të ardhurat për kokë banori në Kosovë janë në nivel prej 11% në raport me vendet e Bashkimit Evropian dhe për të arritur këtë nivel të BE-së, Kosovës i duhet një normë e rritjes prej rreth 8% për 30 vitet e ardhshme. Po ashtu, duke qenë se Kosova qëndron prapa mesatares së vendeve të Evropës Juglindore që nuk janë anëtare të BE-së duke u bazuar , në një varg treguesish kryesorë ekonomik dhe social, të cilët flasin për nivelin e ekonomisë dhe cilësisë së jetës, fillimisht synimi ynë është arritja e nivelit të këtyre vendeve (të ilustruar në tabelën e mëposhtme).

Krahasimi i pesë treguesve të përzgjedhur

Treguesi	Kosova	Mesatarja e vendeve të Evropës Juglindore që nuk janë anëtare të BE-së
Bruto produkti vendor për kokë banori	€2.935	€3.504
Përqindja e papunësisë	30,1%	20,8%
Pjesëmarrja në tregun e punës	40,5%	49,7%
Përqindja e popullsisë që jetojnë në varfëri	29,9%	19,7%
Raporti mes eksporteve dhe importeve	12%	46.5%

Prandaj, në këtë fazë të re të zhvillimit të Kosovës, nevojitet një qasje e re ndaj politikave zhvillimore. Kjo qasje e re i adreson të gjithë faktorët që sot e kufizojnë rritjen ekonomike dhe përmirësimin e standardeve të jetës dhe e cila e trajton zhvillimin si një ndërmarrje shumëdimensionale. Në këtë drejtim, Kosova nuk vuan nga mungesa e strategjive dhe nismave të veçanta të cilat kanë për synim që t'i adresojnë pengesat ndaj zhvillimit veç e veç. Në fakt, kemi strategji të shumta dhe të detajuara sektoriale, por se për shkak të kapaciteteve të kufizuara përballemi me vështirësi në zbatimin e tyre.

Është e nevojshme që strategjitë dhe politikat ekzistuese të integrohen dhe të krijohet një bosht i përbashkët orientues. Ndërkohë që një politikë e mirëfilltë zhvillimore e shtetit kërkon që ato të ndërveprojnë jo vetëm në koherencë ndërmjet tyre, por edhe që të ngushtohet fokusi i masave të shumta të tyre, duke përzgjedhur “**prioritetet më të larta të vendit**”.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim (2016-2021) është pikërisht kjo listë e prioriteteve të larta. Ky është një dokument i cili ka për synim që t'i adresojë pengesat kryesore për zhvillimin e Kosovës. Krijimi i një dokumenti të tillë ka për pikënisje faktin se **një prej pengesave kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit tonë është vetë koordinimi i politikave zhvillimore dhe proceseve institucionale**, të identifikuar nga studime të ndryshme të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Krijimi i një liste të tillë të prioriteteve, në formën e një strategjie ombrellë, do të mundësojë **krijimin e sinergjive** ndërmjet nismave të ndryshme, parandalimin e proceseve të dyfishta institucionale, eficiencë më të lartë të punës, orientimin e përkrahjes nga partnerët zhvillimorë, si dhe vendosjen e një boshti të fuqishëm orientues për institucionet e Kosovës dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve. Hisedarë të këtij dokumenti jemi të gjithë ne – institucionet shtetërore, sektori privat, shoqëria civile, partnerët zhvillimorë, etj. – sepse masat e parapara në këtë dokument **kërkojnë kontributin e secilit** prej nesh për të qenë të efektshëm, qoftë si zbatues apo si mbikëqyrës.

SKZH po ashtu **dallon nga dokumentet e tjera për orientimin e politikave**, sepse si i tillë përfshinë periudhë kohore përtej mandatit të një qeverie dhe është fokusuar në prioritetet e rëndësishme të lartë. Si dokument orientues i politikave zhvillimore nuk adreson të gjitha aspektet e qeverisjes, por vetëm ato që lidhen me zhvillimin gjithëpërfshirës ekonomik dhe social. Për më tepër, ai përfaqëson një dokument nismash zhvillimore të cilat janë objektiva kombëtare që kanë konsensus të gjerë shoqëror.

Njëkohësisht, SKZH është në harmoni të plotë me proceset e tjera strategjike, sikurse procesin e integritimit në BE përmes zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) apo Programit për Reforma Ekonomike (PRE). Kjo është kështu sepse masat e parapara në SKZH janë kryesisht të sinkronizuara me prioritetet e reformave ekonomike dhe institucionale të nevojshme për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian.

SKZH është **dokument i përgatitur nga institucionet të Kosovës**, me rolin prijës dhe koordinues të Zyrës për Planifikim Strategjik (ZPS), e mandatuar nga Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe me mbështetje teknike prej Zyrës së Komisionit Evropian në Kosovë. Procesi për përpilimin e këtij dokumenti ka nisur me vendimin e Qeverisë të datës 03 qershor 2015 dhe ka vijuar me një proces konsultativ brenda mekanizmave shtetëror përmes grupeve punuese, bazuar në punën përgatitore dhe studimore të bërë nga ZPS në vitin paraprak. Dokumenti është hapur edhe për konsultime me publikun dhe janë merr rekomandime dhe ide nga shoqëria civile, sektori privat dhe palët e tjera me interes.

PARIMET UDHËZUESE DHE STRUKTURA E PRIORITETEVE

Përzgjedhja e prioriteteve dhe masave të SKZH është bërë duke u bazuar në dy parime të përgjithshme. Parimi i parë është nevoja për të siguruar **norma vjetore më të larta të rritjes ekonomike**. Kjo nënkupton nevojën për rritjen e të ardhurave, e për rrjedhojë edhe të punësimit dhe të mirëqenies për qytetarët e Kosovës. Parimi i dytë është nevoja që paralelisht me rritjen ekonomike të sigurohet edhe **kohezion shoqëror dhe gjithëpërfshirje**, gjë që nënkupton mospërrjashtimin e grupeve të caktuara të shoqërisë nga përfitimet e rritjes ekonomike. Gjithëpërfshirja është e domosdoshme jo vetëm për shkak se është parakusht për drejtësi shoqërore dhe kohezion, por edhe për shkak se si e tillë ajo mundëson rritje më të madhe dhe më të qëndrueshme ekonomike.

Duke u mbështetur në këto parime themelore, gjatë analizave dhe studimeve paraprake të cilat i kanë paraprirë hartimit të SKZH-së dhe procesit të konsultimeve, janë identifikuar në mënyrë strukturore **pengesat kryesore** të cilat pamundësojnë normë më të lartë të rritjes ekonomike dhe rritje të gjithëpërfshirjes. Më pas janë identifikuar edhe **intervenimet e nevojshme**, apo masat të cilat do të ndërmerren gjatë periudhës së ardhshme gjashtë vjeçare për t'i eliminuar këto pengesa, dhe për ta zhblokuar potencialin ekonomik e social të vendit.

Natyra e pengesave të rritjes ekonomike dhe zhvillimit gjithëpërfshirës është shumë komplekse. Por, shprehur në terma ekonomikë, emëruesi i përbashkët i këtyre pengesave është fakti se ato ndikojnë,

qoftë drejtpërdrejtë apo tërthorazi, në kufizimin e sasisë dhe produktivitetit të kapitalit dhe fuqisë punëtore të vendit – dy faktorët kryesorë të nevojshëm për rritjen ekonomike. Më konkretisht, këto pengesa pamundësojnë rritje ekonomike duke shkaktuar shtrembërime dhe dështime të tregut; duke i dekurajuar investimet e sektorit privat dhe inovacionin, si dhe duke bërë që resurset e vendit të mos shpenzohen në mënyrën më eficiente dhe më efektive të mundshme.

Në anën tjetër, **natyra e intervenimeve** të identifikuar ndaj këtyre pengesave është pragmatike dhe fokusin e ka te arritja e rezultateve të synuara për rritjen ekonomike dhe gjithëpërfshirjen. SKZH nisat nga parimi i qartë se ekonomia e Kosovës do të zhvillohet duke e pasur si shtyllë sektorin privat dhe konkurrueshmërinë, si formën më efektive të krijimit të vlerës dhe alokimit të resurseve në ekonomi. Për të arritur këtë është i domosdoshëm roli aktiv i shtetit për të mundësuar rritjen dhe forcimin e sektorit privat.

Duhet theksuar se intervenimet e përcaktuara janë parimisht udhëzuese dhe orientuese, ku fokusi kryesor është përcaktimi i tyre si prioritetet, **dhe jo detyrimisht zhvillimi i tyre si intervenime finale të detajuara**. Në shumë sektorë tashmë Republika e Kosovës i ka të identifikuar qartë prioritetet dhe formën e zgjidhjes së sfidave, prandaj edhe masat e parapara në këta sektorë janë më të detajuara. Në disa të tjera ka nevojë për konsultime dhe studime të mëtutjeshme për të ardhur tek zgjidhjet e veçanta, prandaj edhe opsionet janë lënë më të hapura apo më të përgjithësuar. Për krijimin e një dokumenti strategjik kornizë si SKZH nuk mund të pritet momenti që të gjitha sfidat të kenë zgjidhje të detajuara të gatshme. Aty ku zgjidhjet janë akoma më të përgjithshme, nevoja për intervenim është përcaktuar si prioritet, prandaj dokumenti si i tillë nuk duhet parë si i ngurtë, por si diçka evoluese, që do të plotësohet vazhdimisht përmes politikave dhe strategjive specifike sektoriale.

Strukturalisht, SKZH është e ndarë në katër shtylla tematike: kapitali njerëzor, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë, zhvillimi i industrive konkurruese, si dhe zhvillimi i infrastrukturës. Këto shtylla bëjnë që kjo të jetë një strategji **që premtun Punë, Ligj, Afarizëm dhe Ndërtim (PLAN)**.

Për ta kuptuar logjikën e këtyre shtyllave dhe ndërlidhjen mes tyre, përfytyroni një biznes i cili synon të investojë në Kosovë dhe kushtet të cilat i duhen atij për të arritur sukses. Ky biznes kërkon atë që e kërkojnë shtyllat e SKZH-së: fuqi punëtore të aftë, sundim të ligjit, skema mbështetëse për biznesin dhe infrastrukturë të qëndrueshme. Plotësimi i këtyre kushteve për të gjitha bizneset shpie në rrugën drejt zhvillimit ekonomik.

Këto shtylla kanë efektin maksimal zhvillimor po që se zbatohen në tërësi, i, sepse suksesi i tyre qëndron tek sinergjia që krijohet prej ndërveprimit të masave, në harmoni të plotë me njëra tjetrën. Si për shembull, efekti i investimeve në infrastrukturë (Shtylla 4) është shumëfish më i madh nëse paralelisht mbyllet hapësirat që mundësojnë abuzime në sistemin e prokurimit publik (Shtylla 2), sepse kështu investimi shkon aty ku duhet dhe me kosto më të ulët. Ofrimi i një skeme për garantimin e kredive për bizneset (Shtylla 3) do të jetë ndihmesë për ndonjë industri të ndryshme krahas zgjidhjes së problemeve të infrastrukturës përcjellëse (Shtylla 4).

SHTYLLA 1: SKZH ËSHTË PLAN PËR PUNË

Ekonomia e një vendi bazohet në masë të madhe në kapitalin njerëzor të saj, prandaj edhe shtylla e parë e strategjisë **jo rastësisht trajton këtë çështje**. Politikat e shteteve në zhvillim shpeshherë kufizohen vetëm në rëndësinë e ekzistimit të infrastrukturës apo burimeve natyrore. Por, për t'i shfrytëzuar burimet natyrore dhe infrastrukturën e një vendi, nevojitet një fuqi punëtore e aftë e cila di të prodhojë gjëra me vlerë.

Kosova sot **qëndron më keq se rajoni sa i përket aftësive të fuqisë punëtore**. Në një kohë kur papunësia në vend është shumë e lartë, paradoksi është se shumë ndërmarrje kanë problem të gjejnë punëtorë të shkathët. Një ndër shkaqet kryesore qëndron te sistemi i arsimit, gjegjësisht tek përfshirja e ulët e fëmijëve në programe parashkollore dhe tek cilësia e mësimdhënies. Problem tjetër gjithashtu përbën mungesa e përputhshmërisë së aftësive dhe shkathtësive të fituara me kërkesat e tregut të punës, teksa mungojnë lidhjet në trekëndëshin ndërmjet shkollave, bizneseve dhe komuniteteve. Në këtë

drejtim nuk janë kapitalizuar sa duhet shkathtësitë e pjesëtarëve të diasporës. Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar i dekurajon investimet dhe është pengesë për ndërmarrjet tona që të rrisin produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e tyre.

Prandaj, në gjashtë vitet e ardhshme, PLAN-i synon që të orientoj politikën në drejtim të kthimit të **fuqisë punëtore të Kosovës në motor të zhvillimit**. Këtë do ta bëjë duke i adresuar mangësitë e sistemit arsimor si dhe duke e shfrytëzuar kapitalin njerëzor të diasporës për transferim të njohurive. Sa i përket arsimit, masat e parapara do të mundësojnë që të rritet përfshirja e fëmijëve të moshës 0-6 në programe parashkollore, të përmirësohet cilësia e mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm si dhe të ndërlihdhen më mirë programet me nevojat e tregut të punës. Këto masa do të përkthehen në sukses më të madh të nxënësve në shkollë. Institucionet e shtetit dhe shkollat do të punojnë edhe për forcimin e mekanizmave të llogaridhënies, në mënyrë që të lidhet suksesi i mësimdhënësve me stimujt apo ndëshkimet, si dhe duke e përmirësuar sistemin e planifikimit të shpenzimeve, ashtu që çdo cent i shpenzuar në arsim të jetë më efektiv.

Investimet në kapitalin njerëzor do të japin rezultatet e tyre në faza të mëvonshme, por kthimi në investime është i sigurt. Një fuqi punëtore më e aftë do të sigurojë **jo vetëm normë më të lartë të rritjes ekonomike, por edhe rritje gjithëpërfshirëse**. Kjo është kështu sepse rritja e përfshirjes së fëmijëve në programe arsimore, përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe ndërlihdhja më e mirë mes shkollave dhe tregut të punës do t'u mundësojë fëmijëve nga familjet e varfra të fitojnë aftësitë dhe shkathtësitë e duhura për t'u integruar në tregun e punës.

SHTYLLA 2: SKZH ËSHTË PLAN PËR FORCIMIN E SUNDIMIT TË LIGJIT

Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë janë çështje të rëndësishme jo vetëm për shkak se sigurojnë drejtësi shoqërore, por se **siguria juridike dhe efektiviteti i institucioneve është parakusht që në një vend të mund të ketë mirëqenie ekonomike**. Ndërtimi i një shoqërie të bazuar në ekonomi të tregut kërkon besim në drejtësinë dhe paanshmërinë e institucioneve, si dhe efektivitetin e tyre në kryerjen e shërbimeve. Pakkush dëshiron të jetojë, e lerë më të investojë para, në një vend ku shteti nuk është paralelisht edhe mbrojtës i interesit publik, edhe mbrojtës i ndërmarrësisë së lirë, sepse vetëm kështu mund të krijohet konkurrencë e ndershme dhe mjedis i përshtatshëm për biznes. Pasiguria juridike e shtyp shpirtin e ndërmarrësisë, dekurajon investimet dhe shkakton pabarazi në një treg të hapur dhe konkurrues duke rezultuar në zvogëlim të rritjes ekonomike.

Kosova ka arritur shumë në ndërtimin e institucioneve dhe infrastrukturës së nevojshme ligjore, sidomos marrë parasysh faktin se ka nisur prej zeros. Por shteti ynë përballet me mjaft **sfida në aspekt të efektivitetit dhe paanshmërisë së shtetit në ofrimin e shërbimeve efektive dhe të drejta** dhe këto sfida përbëjnë pengesë për rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse.

Sot në Kosovë gjykatave u duhet kohë shumë e gjatë për të zgjidhur raste. Kjo e rritë koston e proceseve si dhe i dekurajon qytetarët dhe bizneset që të parashtrajnë raste par mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre. Kosova ka probleme me të drejtat pronësore, që po ashtu janë dekurajuese për investimet dhe kufizojnë mundësitë e qytetarëve për të marrë kredi investuese duke lënë pronat si garanci. Sistemi i prokurimit publik deri më tani ka çaluar dhe është shoqëruar edhe me probleme të mëdha që kanë penguar orientimin e e fondeve publike në tërësi në drejtim të funksionit të zhvillimit. Në anën tjetër, në vazhden e shtet-ndërtimit, shteti ynë dhe administrata publike kanë krijuar rregulla dhe procese administrative, disa prej të cilave janë të panevojshme dhe shkaktojnë jo efikasitet dhe shpenzime të panevojshme, qoftë për shtetin apo për bizneset. Inspektoratet, në anën tjetër, si mekanizma të shtetit për të siguruar garë të ndershme në treg, nuk janë të fuqizuara mjaftueshëm për ta kryer detyrën.

Për këto arsye, **SKZH synon që të rris përkrahjen e shtetit për biznese dhe për të mirën e qytetarëve**, në mënyrë që të stimulohen investimet dhe kështu të mundësohet rritje më e lartë ekonomike dhe trajtim të barabartë të të gjithë qytetarëve para institucioneve të shtetit. Për këtë arsye, janë paraparë masa që do të synojnë forcimin e sistemit të të drejtave pronësore dhe do ta përshpejtojnë zgjidhjen e rasteve nga ana e gjykatave. Po ashtu, në SKZH parashihi masa që do të zvogëlojnë barrën kohore dhe financiare të bizneseve nga proceset administrative, e që njëkohësisht do të ulin shpenzimet operative të shtetit. Forcimi i inspektorateve dhe mbyllja e vrimave në sistemin e

prokurimit publik do të sigurojnë që tregjet të mund të funksionojnë brenda suazave të ligjit dhe që burimet e shtetit të mund të orientohen drejt prioriteteve zhvillimore, përfshi edhe ato të parapara në SKZH.

SHTYLLA 3: SZHK ËSHTË PLAN PËR AFARIZËM

Krijimi i industrive të reja dhe zhvillimi i atyre ekzistuese në një konkurrencë plotësisht të hapur përbën sfidë sidomos për shtetet në zhvillim. Në rastin e Kosovës, pas kolapsit të industrive të kohës së komunizmit, vendi në thelb po kalon nëpër një fazë të ri-industrializimit, të prirë nga sektori privat. Në këtë drejtim, tërheqja e investimeve të huaja direkte (IHD) apo lindja e kompanive vendore kërkon jo vetëm fuqi punëtore të aftë dhe sundim të ligjit, por edhe **rol aktiv të shtetit në adresimin e shtrembërimeve të tregut dhe në ofrimin e shërbimeve lehtësuese dhe favorizuese**, sidomos kur bëhet fjalë për sektorët strategjik. Kosova ka interes që të stimulojë kalimin e ekonomisë në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar dhe në prodhime të tregtueshme, sepse vetëm ky hap cilësor do të mund t'i rrisë të ardhurat në ekonomi.

Deri më sot, bizneset dhe industritë në Kosovë kanë lindur dhe janë rritur pa rolin aktiv të shtetit, ndërkohë që mekanizmat institucionalë të mbështetjes, si edhe investimet në asete strategjike industriale, kanë qenë të kufizuara. Duke **marrë parasysh natyrën e sfidave dhe problemeve me të cilat përballen ndërmarrjet në Kosovë, mbështetja institucionale** është më se e domosdoshme. Normat e interesit pavarësisht trendit rënës në vitin e fundit, mbeten ende të larta dhe lidhen me riskun e vlerësuar nga ana e bankave, ndërkohë që investimet perceptohen me risk të lartë si nga bizneset e huaja po ashtu edhe nga ato të diasporës. Shumë ndërmarrje kanë potencial për t'u rritur por nuk kanë njohuri dhe mjete financimi për t'i arritur standardet e kërkuara të cilësisë për tregjet e eksportit. Në anën tjetër, ndërmarrjet me aksione shtetërore dhe ato strategjike si Trepça, kërkojnë vëmendje të posaçme për t'u rimëkëmbur apo për të rritur efikasitetin, ashtu siç kërkojnë vëmendje edhe sektorët e veçantë siç janë bujqësia dhe agro-industria, ku p.sh. fragmentimi i tokave është problem i madh për krijimin e ekonomive të shkallës.

Për këto arsye, SKZH **synon që të rris përkrahjen e shtetit për procesin e ri-industrializimit në Kosovë**, në mënyrë që ndërmarrjet tona private dhe publike të mund të rriten dhe të kalojnë në aktivitete me vlerë të shtuar më të lartë dhe të prodhojnë mallra të tregtueshme apo shërbime për eksport. Kjo do të thotë, mes tjerash, krijimin e lehtësirave dhe ofrimin e stimuljeve për investitorët strategjikë dhe për projekte dhe nisma që e rrisin konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve, sidomos për arritjen e standardeve të cilësisë për eksport. Mbështetja nënkupton edhe krijimin e mekanizmave për shërbime këshillimore, ofrimin e garancive për kredi apo edhe lehtësimin e rrjetëzimit dhe krijimit të grupimeve industriale ("kllasterëve"). Në rastin e diasporës, mbështetja nënkupton po ashtu edhe krijimin e një skeme të granteve korrespondente që do të stimulonte investimet e diasporës në hapjen e ndërmarrjeve në vendin tonë.

SHTYLLA 4: SKZH ËSHTË PLAN PËR INFRASTRUKTURË

Rëndësia e infrastrukturës për zhvillimin e një vendi është pothuajse e vetëkuptueshme. Studimet tregojnë se sasia dhe cilësia e infrastrukturës është faktori kryesor që e përcakton gatishmërinë e një biznesi për të investuar në një vend. Një biznes dhe një komunitet nuk mund të ketë sukses nëse nuk ka furnizim të rregullt me energji apo rrugë përmes të cilave mund të plasohen mallrat në treg.

Kosova gjatë viteve të fundit ka arritur rezultate të konsiderueshme në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, sidomos të lidhjeve ndërkombëtare. Por mungesa e kapaciteteve financiare ka bërë që të lihet anash njëherë për njëherë edhe rrjeti hekurudhor. Sfidë më e madhe mbetet **sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të lirë me energji elektrike**, teksa kapacitetet ekzistuese për gjenerim janë vjetërsuar dhe mungesa e diversitetit për import ndikon dukshëm në rritjen e çmimeve. Në anën tjetër, teknologjia informative është bërë mjet i përditshëm për përdorim shtëpiak në Kosovë, por jo edhe për përmirësimin e proceseve operative në sektorin privat, institucione publike apo institucione arsimore. Zhvillimi industrial dhe kërkesat e tregut kanë filluar të bëjnë presion serioz ndaj burimeve natyrore si ujërat dhe drunjtë, duke e dëmtuar kështu infrastrukturën elementare për jetë – ekosistemin.

Për këto arsye, SZHK synon që t'i orientojë resurset financiare të shtetit drejt ndërtimit të **aseteve strategjike të infrastrukturës të cilat do të jenë në funksion të zhvillimit**. Në sektorin e energjisë, çështja e sigurisë së furnizimit do të adresohet përmes ndërtimit të kapaciteteve të reja të bazuara në linjit, ndërkohë që do të shqyrtohen mundësitë për përdorimin e burimeve të ripërtërishme nga uji dhe biogasi. Çështja e kostos do të adresohet përmes diversifikimit të burimeve të importit dhe uljes së konsumit me anë të masave të efijencës. Infrastruktura e transportit rrugor do të zgjerohet përmes përfundimit të autostradave ndërkombëtare që janë në ndërtim e sipër dhe nisjes së ndërtimit të autostradave rajonale, ndërkohë që do të bëhet edhe modernizimi i linjës së vetme hekurudhore ndërkombëtare për të lehtësuar transportin e mineraleve për eksport dhe të prodhimeve bujqësore. Masa të veçanta do të sigurojnë edhe investime që do të mundësojnë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, duke siguruar balancë mes nevojave zhvillimore dhe kujdesit ndaj mjedisit.



KAPITALI
NJERËZOR

Pse kapitali njerëzor?

Një prej arsyeve përse kompanitë nga vendet e zhvilluara i zhvendosin aktivitetet e tyre në shtetet në zhvillim si Kosova, apo kur një kompani kosovare ka përparësi ndaj një kompanie të një vendi të zhvilluar, është fakti se në këto shtete kostoja e prodhimit është më e ulët për shkak të fuqisë punëtore më të lirë. Një biznes do të jetë i favorizuar nëse do t'i duhet të shpenzojë më pak para për ta nxjerrë një produkt në treg. Por në mënyrë që ky investim të ketë kuptim, punëtorët në Kosovë duhet të jenë po aq produktiv dhe të shkathët si ata në vendet e zhvilluara. Një investitor mund të sjellë makinerinë më moderne në Kosovë, por shtrohet pyetja se a do të mund të gjejë ai fuqi punëtore që ka shkathësitë dhe kualifikimet e duhura për të punuar me pajisje të tilla dhe për të prodhuar produkte të cilësisë së kërkuar me ato pajisje?

Kapitali njerëzor u referohet shkathtësive të fuqisë punëtore për të përdorur në mënyrë efektive kapitalin fizik, siç janë makinat. Disa punëtorëve u duhet më pak kohë se të tjerëve për ta prodhuar të njëjtën gjë. Disa e bëjnë punën më mirë se të tjerët. Kapitali njerëzor gjithashtu ka të bëjë me aftësinë e njerëzve për të qenë inovativ dhe për të zhvilluar teknologji, procese apo prodhime të reja. Këto gjëra përcaktojnë suksesin e një kompanie në një treg ndërkombëtar konkurrues. Si të tilla, ato e përcaktojnë nëse një shtet do të zhvillohet ose jo. Sa më të përparuara që të jenë shkathtësitë e fuqisë punëtore, aq më të larta do të jenë të ardhurat e punëtorëve dhe të ekonomisë në përgjithësi.

Kur flitet për shkathësitë, nuk flitet vetëm për shkathësitë teknike, si për shembull prerja dhe formësimi i një produkti, por edhe për shkathësitë kognitive, si logjika dhe arsyetimi, apo shkathësitë e buta si marrëdhënia me kolegët apo etika e punës. Krijimi i këtyre shkathtësive varet kryesisht nga cilësia e sistemit të arsimit, ndërlidhja e tij me tregun e punës, kushtet në të cilat njerëzit punojnë në tregun e punës, por edhe mundësitë për fitimin e aftësive përmes migrimit, apo kthimit të trurit nga diaspora.

Ndërhyrja e SKZH

Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore. Kjo do të mundësojë sukses më të madh në nivele më të larta të arsimit, uljen e pabarazisë dhe rritjen e pjesëmarrjes së femrave në tregun e punës. Kjo do të thotë se një fëmijë mund të mësojë ndërkohë që nëna e tij punon.

Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm. Ky është një parakusht për sukses më të madh të sistemit të arsimit dhe forcimit të aftësive të rinisë për tregun e punës. Kjo nënkupton se mësimdhënësit tanë të cilët i mësojnë fëmijët tanë janë të kualifikuar për punën që bëjnë.

Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës. Kjo do të kontribuojë në uljen e papunësisë dhe rritjen e ndërmarrjeve kosovare. Kjo do të thotë se një nxënës/e i/e shkollës profesionale apo student/e nga universiteti do të mund të gjejnë më lehtë punë praktike gjatë studimeve apo angazhim të plotë pas studimeve.

Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe certifikimit në sistemin arsimor. Kjo do të mundësojë që shkollat dhe mësimdhënësit të japin llogari si dhe të shpërblehen për cilësinë e punës, gjë që do të ndihmojë në rritjen e cilësisë së arsimit.

Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin e arsimit. Kjo do të mundësojë kursime në buxhetin e shtetit dhe riorientim të mjeteve nga ato fusha që janë më pak prioritare tek ato më prioritare.

Ulja e nivelit të punësimit joformal. Kjo do të mundësojë mbrojtjen dhe avancimin më të mirë të punëtorëve. Po ashtu, një punëtor/e do të mund të përfitojë pension, të ketë qasje në kredi dhe kushte më të mira në punë.

Angazhimi konkret i ekspertëve dhe studentëve të diasporës. Kjo do të mundësojë transferimin e aftësive të fituara nga mërgata jonë dhe forcimin e lidhjeve të tyre me atdheun. Do të thotë se një ekspert i teknologjisë mund të mbështetet financiarisht për ta zhvilluar një projekt në institucionet e Kosovës apo në kompani private, i cili mund të prodhojë diçka afatgjatë.

GJITHPËRFSHIRJA NË ARSIMIN PARASHKOLLOR DHE PARAFILLOR

CILA ËSHTË SFIDA? Përfshirja e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç në Kosovë në programe arsimore është shumë më e ulët se në rajon. Regjistrimi në arsimin parashkollor dhe parafillor është në nivelin prej 25-30% ndërsa ka dallime ndërmjet zonave urbane dhe rurale (ku në zona rurale përfshirja është shumë e ulët). Përfshirja në aktivitetet parashkollore ka rol vendimtar në performancën më të mirë në fazat e tjera të arsimit, meqenëse moshën 0-6 është vendimtare për zhvillimin kognitiv. Ajo gjithashtu ka efekt pozitiv në rritjen e pjesëmarrjes së femrave në tregun e punës, teksa mungesa e institucioneve parashkollore bën që ato të detyrohen të mbeten në shtëpi.

CILAT JANË SHKAQET? Në nivelin parashkollor, problemi kryesor është mungesa e infrastrukturës fizike dhe kuadrit mësimdhënës, ndërsa në nivelin parafillor problemi qëndron më shumë në infrastrukturën e mangët.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH synon që të rrisë përfshirjen e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe parafillor. Më konkretisht, synimi është që të arrihet përfshirje universale në arsimin parafillor dhe të rritet numri i fëmijëve që ndjekin arsim parashkollor për 5000 fëmijë në vit deri në vitin 2021. Kjo do të bëhet përmes rritjes së numrit të kopshteve publike dhe rritjes së përfshirjes përmes institucioneve private.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Rritja e numrit të kopshteve publike. Fillimisht do të ndërtohen 18 kopshte për edukim parashkollor në bazë të propozimeve dhe kërkesave të komunave me nevoja më urgjente dhe atyre që nuk kanë fare kopshte publike. Paralelisht do të bëhet vlerësimi dhe evidentimi i shërbimeve ekzistuese të arsimit parashkollor dhe parafillor, përfshi ofruesit publik dhe privat, si dhe vlerësimi i hendekut në qasje.*
- 2) *Rritja e përfshirjes në institucione private. Kjo do të bëhet përmes licencimit të institucioneve të reja parashkollore, rilicencimit të institucioneve ekzistuese (rreth 124 kopshte) si dhe krijimit të stimujve për zgjerimin e rrjetit të institucioneve private. Për këtë është i nevojshëm përmirësimi i kornizës ekzistuese ligjore për edukimin dhe kujdesin e hershëm të fëmijëve, me fokus në krijimin e standardeve të përbashkëta të cilësisë dhe shërbimeve (p.sh. pagesat, tarifat, kushtet e veprimtarisë, etj).*
- 3) *Optimizimi i personelit mësimdhënës përmes rialokimit prej niveleve më të larta (arsimit fillor). Kjo do të mundësojë adresimin e problemeve që ndërlidhen me numrin e mësimdhënësve që do të jenë në dispozicion dhe cilësinë e tyre. Çështjet e trajnimit dhe kualifikimit janë të adresuara në masat e tjera të SKZH dhe ato përfshijnë ndërtim kapacitetesh edhe për nivelin parashkollor dhe parafillor.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Rezultati i kombinuar i aktiviteteve të lartpërmendura do të jetë rritja e përfshirjes në arsimin parashkollor dhe parafillor. Efekti tjetër dhe i tërthortë do të jetë përmirësimi i suksesit të nxënësve në nivelin fillor dhe nivelet e tjera. Po ashtu, një efekt tjetër i tërthortë do të jetë edhe rritja e pjesëmarrjes së femrave në tregun e punës. Përmirësimi i suksesit të nxënësve do të mundësojë forcimin e shkathtësive të fuqisë punëtore, e kjo për një periudhë afatgjatë do të mundësojë rritje më të madhe ekonomike dhe të ardhura më të larta.

PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË MËSIMDHËNIES NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

CILA ËSHTË SFIDA? Suksesi i nxënësve kosovarë në nivelin e arsimit fillor, sipas projekteve të testit të standardizuar PISA, është më i ulëti në rajon. Pamundësia për të fituar njohuri dhe shkathtësi në nivelet më të ulëta të arsimit ndikon shumë në aftësinë e këtyre nxënësve për të treguar sukses në nivelet më të larta.

CILAT JANË SHKAQET? Studimet tregojnë se cilësia e mësimdhënies është faktori më i rëndësishëm për përmirësimin e rezultateve të nxënësve në shkollë. Në këtë drejtim, Kosova përballlet me sfida të mëdha. Rreth gjysma e mësimdhënësve të cilët momentalisht janë në shërbim nuk i plotësojnë kualifikimet minimale dhe as kërkesat normative për të qenë mësimdhënës, sepse nuk i kanë përfunduar studimet e nivelit baçelor. Rritja e pagave nuk është shoqëruar me rritje në cilësinë e mësimdhënies ndërkohë që vetëm rreth 10% të shkollave e zbatojnë kurrikulën e re. Shumica e shkollave e ndërtojnë punën mbi libra që nuk janë azhurnuar.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH synon që të rrisë cilësinë e mësimdhënies në nivelin fillor duke i forcuar kapacitetet e mësimdhënësve si dhe duke i forcuar mekanizmat e llogaridhënies. Do të forcohet ndërlidhja mes nivelit të përgatitjes së mësimdhënësve, rezultateve të tyre në punë dhe pagës të cilën do ta marrin. Është e nevojshme edhe një skemë e pensionimit të hershëm dhe rikualifikimit të mësimdhënësve, si dhe përmirësimi i teksteve shkollore dhe zgjerimi i përdorimit të planprogramve të reja në të gjitha shkollat.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Rishikimi dhe përfundimi i procesit të kualifikimit të mësimdhënies para futjes në shërbim. Kjo e përfshin testin përfundimtar kombëtar të mësimdhënësve dhe zhvillimin e një sistemi të qartë për licencimin e mësimdhënësve.*
- 2) *Optimizimi i numrit të mësimdhënësve ekzistues duke e pasur për kriter cilësinë. Procesi i vlerësimit do të përfundojë me pensionimin e parakohshëm të një numri prej tyre, si dhe zbatimin të skemës së rikualifikimit për të paktën 500 mësimdhënës që do të mbesin në sistem. Paralelisht do të ndërtohet sistemi i vlerësimit të suksesit të mësimdhënësve dhe i ndërlidhjes së këtij sistemi me sistemin e pagave, duke krijuar kështu llogaridhënie për cilësinë e mësimdhënies.*
- 3) *Përsheptimi i procesit të zhvillimit profesional të mësimdhënësve, me fokus të veçantë në segmentet e mësimdhënësve të arsimit profesional dhe në fushat STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë).*
- 4) *Zgjerimi i përdorimit të kurrikulës së re në të gjitha shkollat e mbetura. Njëkohësisht do të realizohet edhe vlerësimi i efikasitetit në shkollat pilot (10%) si dhe do të bëhen korrigjime sistematike në kurrikulë aty ku ka nevojë.*
- 5) *Rishikimi i teksteve ekzistuese për t'ju përshtatur më mirë nxënësve, si dhe zhvillimi i teksteve të reja sipas rezultateve të pritura të të nxënësve. Ndërsa, sipas specifikave që ka arsimit profesional, do të bëhet zhvillim i teksteve bazë për profilet përkatëse dhe materialet e tjera shkollore.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Deri në vitin 2021 Kosova synon të rrisë në 100% numrin e mësimdhënësve të cilët i plotësojnë kriteret minimale të kualifikimit. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies do të përmirësojë rezultatet e nxënësve në shkollë në testet e standardizuara (p.sh. PISA) si dhe do t'i forcojë aftësitë dhe shkathtësitë e fuqisë punëtore. E gjithë kjo do të ketë ndikim afatgjatë edhe në rritjen dhe zhvillimin ekonomik.

NDËRLIDHJA MË E MIRË NDËRMJET SISTEMIT ARSIMOR DHE TREGUT TË PUNËS

CILA ËSHTË SFIDA? Mospërputhja e nevojave të tregut të punës me njohuritë e fituara në arsimin e lartë dhe profesional është identifikuar si një prej pengesave kryesore për rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik në vend. Rreth 25% të firmave në Kosovë ende ankohen se fuqia punëtore ka shkathtësi të mangëta dhe të papërputhshme me nevojat e tyre. Në anën tjetër, më shumë se 85% të investitorëve e nënvizojnë cilësinë e fuqisë punëtore si faktor kryesor kur marrin vendime për investime.

CILAT JANË SHKAQET? Në Kosovë nuk ka sistem për parashikimin e shkathtësive të kërkuara në tregun e punës. Procesi i hartimit të standardeve profesionale të kualifikimit është i ngadalshëm, ashtu sikurse edhe zbatimi i Kornizës Kurrikulare. Niveli i shpenzimeve publike për arsim dhe aftësim profesional është shumë i ulët, ndërkohë që të paktën çereku i shkollave profesionale nuk ofrojnë mundësi të punës praktike në shkollë apo jashtë saj. Ndërmarrjet nuk kanë stimuj për të marrë në punë praktikantë. Shkollat nuk ofrojnë orientim në karrierë e as mundësi për ndërlidhje me ndërmarrjet përmes hulumtimeve dhe zhvillimeve të produkteve (R&D).

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH synon që të forcojë ndërlidhjen ndërmjet programeve arsimore dhe nevojave të tregut të punës përmes përcaktimit të standardeve profesionale dhe fushave prioritare, si dhe zbatimit të kurrikulave bërthamë dhe trajnimeve për mësimdhënës. Sistemi i arsimit profesional do të bëhet sa më praktik, duke përfshirë ndjekje të mësimin në ndërmarrje. Rol qenësor do të luaj edhe krijimi i një sistemi për parashikimin e nevojave për shkathtësi, si dhe ndërlidhja e punës hulumtuese në universitete me industrinë, përmes specializimeve të mençura.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Përshpejtimi i procesit të zhvillimit të standardeve profesionale, në përputhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK) dhe Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), si dhe me Sistemin e rishikuar Kombëtar për Klasifikimin e Profesioneve.*
- 2) *Përcaktimi i fushave me prioritet më të lartë në AAP duke u konsultuar me politikat zhvillimore të Kosovës dhe sektorët prioritarë. Zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulave bërthamë në një format modular, sipas fushave prioritare të AAP-së si dhe realizimi i programit për trajnimin e mësimdhënësve të AAP-së për ata sektorë, bazuar në standardet e profesionit.*
- 3) *Zbatimi i sistemit pilot i kombinuar i AAP-së me elemente të mësimin të dyfishtë (kombinimi i të mësuarit në shkollë dhe në ndërmarrje) duke filluar me fushat prioritare në AAP dhe duke ndjekur kurrikulën bërthamë. Do të koordinohet sistemi i subvencionimit të pagave me fushat prioritare, në mënyrë që të mundësohet integrimi më i mirë i të diplomuarve të AAP-së në tregun e punës.*
- 4) *Zhvillimi dhe zbatimi i Sistemit Kombëtar i Parashikimit të Nevojave për Shkathtësi. Kjo do të bëhet duke e siguruar ndërlidhjen me sistemin e orientimit në karrierë brenda shkollave dhe shërbimet e punësimit/të mësuarit gjatë gjithë jetës. Do të krijohen kushtet për shërbime dhe studime përcjellëse për të gjurmuar përparimin në karrierë.*
- 5) *Ndërlidhja e punës hulumtuese në universitete me industrinë përmes qasjes së specializimeve të mençura në përputhje me strategjinë Evropa 2020. Kjo nënkupton investime publike dhe private për hulumtim dhe zhvillim (R&D) në një numër të caktuar sektorësh industrial.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i këtyre masave do të kontribuojë në krijimin e një fuqie punëtore më të punësueshme dhe ndërmarrjeve më efektive dhe produktive. Përputhja më e madhe e shkathtësive të fuqisë punëtore me nevojat e tregut të punës do të ndihmojë në rritjen e investimeve, punësimit, të ardhurave dhe rritjen e ndërmarrjeve ekzistuese. E gjithë kjo do të mundësojë rritje më të lartë ekonomike dhe zhvillim më të qëndrueshëm.

FORCIMI I FUNKSIONEVE TË PROVIMIT, INSPEKTIMIT DHE AKREDITIMIT NË SISTEMIN ARSIMOR

CILA ËSHTË SFIDA? Sistemi arsimor në Kosovë vuan nga mungesa e mekanizmave efektivë të vlerësimit të suksesit dhe cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Mungesa e këtyre mekanizmave efektivë u pamundëson shkollave që t'i kuptojnë mangësitë dhe të ndërhyjnë për përmirësimin e tyre, si dhe nuk u jep institucioneve qendrore dhe lokale mjete për të kërkuar llogari prej institucioneve arsimore. Si rrjedhojë e kësaj situatë pëson cilësia e arsimimit dhe mundësia e fëmijëve dhe të rinjve kosovarë për të përfituar njohuri dhe shkathtësi.

CILAT JANË SHKAQET? Sistemi i ekzaminimit të jashtëm të nxënësve është ende i pazhvilluar, iu mungon kredibiliteti, dhe prodhimi i të dhënave të besueshme. Testet akoma nuk janë sistematike dhe të standardizuara me praktikën ndërkombëtare për të mundësuar analiza krahasuese. Inspektimi i shkollave dhe mbikëqyrja e cilësisë vuan nga kapacitetet e dobëta të inspektoratëve, si dhe nga mungesa e kornizës për vlerësimet e jashtme. Autoritetet akredituese kanë mungesë të autonomisë dhe llogaridhënies për performancën e tyre.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH do t'i forcojë funksionet e provimit, inspektimit dhe akreditimit me synim që të rrisë llogaridhënien dhe përgjegjësinë e personelit mësimor për punën që bën. Kjo do të arrihet nëpërmjet rritjes së kapaciteteve, krijimit të një sistemi të besueshëm të testimit final për nxënësit dhe profesionet e rregulluara; vlerësimit të suksesit të mësimdhënësve dhe forcimit të autoriteteve akredituese.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) Rritja e kapaciteteve të Këshillit Kombëtar të Cilësisë për t'i zbatuar Udhëzimet Standarde Evropiane dhe rekomandimet e ENQA/EQAR, si dhe plotësimi i akreditimit me një proces më gjithëpërfshirës të rankimit të programeve sipas Kornizës Multidimensionale Evropiane.
- 2) Zbatimi i një sistemi më të besueshëm të provimit final për nxënës – duke përfshirë këtu testin pas klasës 5, gjysmë-maturën dhe testin PISA. Arritshmëria e nxënësve/studentëve do të jetë e krahasueshme dhe do të standardizohet sipas testeve ndërkombëtare PISA, TIMSS, PIACC.
- 3) Përmirësimi i provimit final për profesionet e rregulluara (në përputhje me Direktivën EC 2005/36 të BE-së). Për këtë arsye do të operacionalizohet Agjencia për Standarde dhe Vlerësim, si dhe Këshilli Shtetëror për Profesionet e Rregulluara.
- 4) Zgjerimi dhe përmirësimi i sistemit të inspektimeve në sistemin arsimor edhe aspekteve të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve, përfshi ato menaxhuese, pedagogjike dhe ligjore.
- 5) Përmirësimi i cilësisë së autonomisë dhe llogaridhënies së institucioneve të akredituara përmes zhvillimit dhe zgjerimit të kapaciteteve të Autoriteteve Akredituese (AAK dhe AKK).
- 6) Zhvillimi i një sistemi të vlerësimit të suksesit të mësimdhënies si dhe një sistem të gradimit të mësimdhënësve. Sistemi i gradimit duhet të vlerësojë kualifikimin, performancën e mirë dhe përvojën. Arritshmëria e nxënësve dhe raportet e inspektimit do të jenë pjesë thelbësore e kriterëve të vlerësimit.

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i këtyre masave do të mundësojë vlerësim më të besueshëm, transparent dhe të krahasueshëm të performancës së studentëve. Rritja e praktikave të llogaridhënies dhe sigurimit të cilësisë do të rezultojë me performancë më të mirë të sistemit arsimor dhe si rrjedhojë edhe rritjen e aftësive dhe shkathtësive të fuqisë punëtore. Forcimi i kapitalit njerëzor do të mundësojë rritje më të madhe ekonomike dhe zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik.

OPTIMIZIMI I SHPENZIMEVE NË ARSIM NËPËRMJET SISTEMEVE TË TË DHËNAVE

CILA ËSHTË SFIDA? Deri më tani, financimi i sistemit të arsimit nuk është lidhur me trendët demografikë dhe me vlerësimin e nevojave të zhvillimit të kapaciteteve të mësimdhënësve. Shpenzimet bëhen në mënyrë jo sistematike. Kjo bën që trendët dhe nevojat të mos parashihen në kohë dhe shkakton mungesë efikasiteti në përdorimin e mjeteve. Përmirësimi i cilësisë dhe masat e parapara në SKZH kërkojnë burime shtesë të cilat duhet të merren parasysh gjatë planifikimit financiar. Ato pjesërisht mund të realizohen nëpërmjet veprimeve efikase në sistemin aktual, për të cilin nevojitet një sistem më efikas i informimit.

CILAT JANË SHKAQET? Mungon një master plan i shkollave i cili përfshin planet lidhur me kapacitetet dhe nevojat bazuar në projeksionet demografike apo kapacitetet njerëzore të sistemit. Njëkohësisht mungojnë edhe sistemet për menaxhimin e informatave në sistemin arsimor, apo ndërlidhja e tyre me sistemet e tregut të punës.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH do të përmirësojë planifikimin e shpenzimeve në sistemin e arsimit përmes ndërtimit të sistemeve të të dhënave që i projektojnë trendët për vitet e ardhshme për një varg treguesish të rëndësishëm për sistemin arsimor. Ky synim do të arrihet duke pasur informata më të detajuara për rrjetin e shkollave dhe nevojat e tyre, përfshi edhe pilotimin e mundshëm të modelit të Partneriteteve Publiko Private (PPP), si formë alternative e financimit të sistemit të arsimit profesional.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Ndërtimi i një master plani për rrjetin shkollave të AAP-së, për institucionet e të mësuarit gjatë tërë jetës dhe për shërbimet e punësimit, në përputhje me ndryshimet demografike, nevojat e sistemit arsimor dhe parimin e shpenzimit efikas të fondeve publike. Ky master plan do të krijojë kurse të cilat do të mundësojnë rritjen e shpenzimeve për investim në përmirësimin e qasjes dhe cilësisë në arsim.*
- 2) *Krijimi i Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë (SMIAL) si dhe do zhvillimi i mëtutjeshëm i sistemeve të tjera informative lidhur me sistemin arsimor, tregun e punës dhe ndërlidhjen mes tyre.*
- 3) *Rritja e financimit për programet e arsimit profesional dhe arsimin e lartë. Kjo do të bëhet duke e rishikuar formulën e tanishme të financimit dhe duke i riorientuar shpenzimet nga fushat më pak prioritare në ato më prioritare.*
- 4) *Pilotimi i modelit të Partneriteteve Publiko-Private në fushat/shkollat e përzgjedhura të AAP, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e arsimit në fushën e AAP.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i këtyre masave do të rrisë efikasitetin e shpenzimeve publike në sistemin arsimor, duke mundësuar kurse dhe duke i riorientuar investimet prej fushave më pak prioritare në ato më prioritare. Përdorimi më efikas i mjeteve buxhetore do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë në sistemin arsimor si dhe në zbatimin e reformave që synojnë rritjen e përfshirjes në nivelin parashkollor. Përmirësimi i cilësisë dhe rritja e përfshirjes do të kenë ndikim në forcimin e kapaciteteve të fuqisë punëtore të Kosovës, gjë që do të ndihmojë në rritjen ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm.

ANGAZHIMI AFATSHKURTËR I EKSPERTËVE DHE STUDENTËVE TË DIASPORËS

CILA ËSHTË SFIDA? Gjatë dekadave të fundit, në vende të ndryshme të botës, diaspora kosovare ka fituar njohuri dhe shkathtësi të cilat do të ishin të dobishme për t'u transferuar në ekonominë e Kosovës. Studimet tregojnë se të kthyerit nga diaspora të cilët posedojnë shkathtësi kanë arritur të gjejnë punë në Kosovë shumë më lehtë sesa të kthyerit që nuk posedojnë shkathtësi, gjë që tregon se ata janë një kapital njerëzor shumë i vlefshëm. Sidoqoftë, deri më tani, i ashtuquajturimi procesi i kthimit të trurit, është zhvilluar në mënyrë sporadike dhe pa mbështetje institucionale. Krijimi i mekanizmave që do të lehtësonin angazhimin e diasporës do të mundësonte jo vetëm transferimin e shkathtësive, por edhe potencialisht do të ndihmonte në kthimin e përhershëm të një numri të caktuar të pjesëtarëve të diasporës me shkathtësi.

CILAT JANË SHKAQET? Për momentin, për sa i takon skemave për transferimin e shkathtësive, ekziston vetëm një program i cili i jep shtytje kthimit të akademikëve – gjegjësisht, programi për kthimin e trurit i zbatuar nga MASHT. Megjithatë, ai nuk ka qenë i suksesshëm. Në fushën e administratës civile, Fondi i Kuadrove deri më tani ka ofruar paga shtesë për staf me kualifikime të larta në shërbimin civil, por ai vlen për të gjithë, e jo vetëm për Diasporën. Nuk ka skema që do të mundësonin angazhimin e diasporës në sektorin privat e as për përfshirjen e tyre në universitetet e Kosovës.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH do të krijojë mekanizma konkret për angazhimin afatshkurtër të ekspertëve dhe studentëve të diasporës në institucionet publike, private dhe arsimore në Kosovë, në mënyrë që ta lehtësojë transferimin e shkathtësive dhe forcojë kapitalin njerëzor në vend.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) Krijimi i një databaze e cila e përdorë regjistrin e diasporës për identifikimin e profileve të ndryshme të mërgatës. Në këtë databazë do të publikohen profilet të cilat janë të nevojshme për angazhim në Kosovë, kohëzgjatja e angazhimit, subvencionet në dispozicion, etj.
- 2) Krijimi i Programit për Angazhim në Atdhe (PAA) i cili do të fillojë së zbatuari në vitin 2016. Ky program do t'u mundësojë ekspertëve dhe studentëve të diasporës që të kenë angazhime afatshkurtra në institucione publike, arsimore apo kompani private. Në program do të përfshihet mbështetja përmes subvencioneve për: a) angazhime profesionale në fushën e ekspertizës për ekspertë; b) praktika profesionale për studentë e të rinj; c) ndjekje studimesh në universitetet publike apo private të Kosovës. Në zbatimin e programit do të përfshihen edhe rrjetet e studentëve apo rrjetet profesionale të diasporës.
- 3) Kosova do të bëhet pjesë e Programit për Kthimin e Ekspertëve të Qeverisë së Gjermanisë në vitin 2016. Programi do t'u mundësojë ekspertëve të diasporës nga ky vend që të kenë angazhime afatshkurtra në Kosovë të ngjashme me ato të PAA.
- 4) Kosova dhe UNV (Programi i Kombeve të Bashkuara për Vullnetarë) do të zbatojnë programin TOKTEN për angazhimet afatshkurtra vullnetare të pjesëtarëve të diasporës.
- 5) Krijimi i një programi mësimor online (e-learning) ku do të mund të bashkëvepronin studentët me ekspertët e fushave të ndryshme.

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i këtyre masave do të mundësonte angazhimin konkret dhe të përkohshëm të një numri të konsiderueshëm të pjesëtarëve të diasporës në institucionet publike, arsimore ose në kompani private. Gjithashtu, kjo do të nxiste krijimin e mundshëm të nismave (projekteve apo kompanive) nga pjesëtarët e angazhuar prej diasporës. Institucionet publike dhe firmat private do t'i rrisin kapacitetet e tyre për shkak të transferimit të shkathtësive. Kontributi i kapitalit njerëzor nga diaspora kësaj do të luajë rol të rëndësishëm në sigurimin e normave më të larta të rritjes ekonomike.

ADRESIMI I PUNËSIMIT JOFORMAL DHE KRIJIMI I KUSHTEVE TË PËRSHTATSHME PËR PUNË

CILA ËSHTË SFIDA? Grupe të caktuara të shoqërisë, sidomos ato që jetojnë të marginalizuara, janë të detyruara që të punojnë në sektorin joformal, ku përveç tjerash nuk gëzojnë kurrfarë mbrojtje – ligjore, shëndetësore, të sigurisë fizike, etj. Përveç kësaj, puna në kushte të informalitetit kufizon marrjen e shumë përfitimeve, si për shembull qasjen në financa. Të punuarit në informalitet përgjithësisht e vështirëson mobilitetin e shtresave të varfra të shoqërisë dhe forcimin e kapaciteteve të tyre njerëzore.

CILAT JANË SHKAQET? Informaliteti i lartë në punësim shkaktohet nga mungesa e zbatimit të mirëfilltë të legjislacionit mbi të drejtat e punëtorëve, sidomos nga ana e inspektoratit të punës. Ky i fundit vuan nga mungesa e kapaciteteve qoftë njerëzore, qoftë teknologjike, si për shembull sistemet për menaxhimin e informatave. Problem tjetër i veçantë është edhe mungesa e vetëdijesimit në mesin e punëtorëve për përfitimet nga formalizimi i aktivitetit të tyre.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH do të punojë që të fuqizojë rolin e partnerëve social në zhvillimin e politikave socio-ekonomike të vendit në mënyrë që t'i përmirësojë kushtet e punës dhe zvogëlojë punësimin joformal në Kosovë.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Forcimi i dialogut të institucioneve me partnerët social, në veçanti me organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve të strukturave, si dhe sistemit të punës së Këshillit Ekonomik Social (KES). Paralelisht bashkë me partnerët social do të punohet në rritjen e vetëdijesimit të punëtorëve përmes fushatave vetëdijesuese lidhur me punësimin joformal.*
- 2) *Përmirësimi i të drejtave të punëtorëve dhe garantimi i minimumit të standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë, sipas standardeve ndërkombëtare. Kjo do të bëhet nëpërmjet përmirësimit të kornizës ligjore, ngritjes së vetëdijes dhe monitorimit më të mirë të zbatimit të kësaj kornize ligjore. Në vitin 2016 do të hartohen 10 akte nënligjore nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë që do të përafrohen me 10 direktiva të BE-së nga kjo fushë.*
- 3) *Përforcimi i mekanizmave dhe bashkërendimi i veprimeve institucionale për zvogëlimin e punësimin joformal, përmes krijimit të një platforme dhe trupe të përbashkët të inspektimit në terren.*
- 4) *Krijimi i sistemit për menaxhimin e informatave në Inspektoratin e Punës. Ky sistem do të ketë mundësinë e kontrollit të mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë nga menaxhmenti më i lartë në MPMS dhe Inspektorati i Punës të punës së inspektorëve në terren. Përmes këtij sistemi informativ do të shkëmbehen informata edhe me Administratën Tatimore të Kosovës dhe Trustin Pensional të Kosovës.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i këtyre masave do të ulë nivelin e punësimin joformal në ekonominë e Kosovës. Ulja e këtij niveli dhe përmirësimi i kushteve të punës për fuqinë punëtore të Kosovës do të përmirësojë mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës.



QEVERISJA E MIRË
DHE SUNDIMI I
LIGJIT

Pse qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit?

Një ndër shtyllat kryesore për krijimin e një ekonomie funksionale të tregut është siguria juridike dhe efikasiteti i institucioneve në ofrimin e shërbimeve. Çdo kompani e cila dëshiron të investojë në një vend ka dëshirë të dijë nëse në këtë vend mund të llogarisë në gjykata efikase dhe të drejta, në ligje të thjeshta që garantojnë pronën dhe zbatim të kontratatave, apo shërbime efektive mbështetëse të administratës publike.

Pakkush është i gatshëm që të rrezikoj investimin në një vend nëse ka dyshime se gjykata nuk do t'ia garantojë zbatimin e kontratatave, apo nëse administrata publike do të jetë e paparashikueshme, joprofesionale, bën ndëshkime të padrejta në emër të rregullimit të tregut dhe ngarkon bizneset me procedura të panevojshme. Pengesat e tilla ia rrisin ndërmarrjeve koston e të bërit biznes. Në një botë gjithnjë e më konkurruese, ndërmarrjet nuk do të kenë problem që t'i drejtojnë investimet diku tjetër ku do ta gjejnë këtë siguri juridike dhe efikasitet institucional. Prandaj, dekurajimi dhe pengesat e tilla të lartpërmendura ndaj investimeve pamundësojnë rritjen ekonomike të një vendi.

Mungesa e efikasitetit të sistemit gjyqësor e dëmton edhe kohezionin social dhe ofrimin e mundësive të barabarta për shtresat e marginalizuara. Institucionet, në të cilat dominon arbitrariteti dhe jo fjala e shkruar e ligjit, i dëmtojnë më së shumti të varfrit, duke i marginalizuar edhe më tej ata në kushtet e përjashtimit. Fenomenet, si korrupsioni dhe administrimi joefikas, bëjnë që resurset e shtetit të drejtohen drejt atyre që kanë fuqi dhe kontroll dhe jo drejt nevojave prioritare të zhvillimit dhe uljes së varfërisë.

Ndërhyrja e SKZH

- **Fuqizimi i sistemit të të drejtave pronësore.** Kjo do të krijojë siguri juridike te investitorët dhe do t'ju mundësojë qytetarëve që t'i përdorin pronat si kolateral për qasje në financa. Do të thotë se një biznes do të mund të llogarisë se tokën që e ka blerë e ka të sigurt për të zhvilluar aktivitetet ekonomik.

- **Rritja e efikasitetit të gjykatave për zgjidhjen e rasteve.** Kjo do ta përshpejtojë dukshëm kohën e nevojshme për zgjidhjen e rasteve e për rrjedhojë do ta ulë edhe koston e proceseve për qytetarët dhe bizneset, si dhe do të ndihmojë në krijimin e një klime të favorshme për tërheqje të investimeve.

- **Mbyllja e hapësirave për abuzime në sistemin e prokurimit publik.** Kjo do të mundësojë uljen e nivelit të korrupsionit dhe alokimin më të mirë dhe më të drejtë të resurseve në ekonomi, që do të thotë se duke rritur transparencën dhe efikasitetin promovohet konkurrenca e drejtë, duke garantuar një trajtim të drejtë dhe parim jo-diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë.

- **Përmirësimi i mëturjeshëm i ofrimit të shërbimeve për bizneset dhe qytetarët.** Kjo konsiston me krijimin e një sistemi të integruar informativ për shërbimet e administratës publike, duke bërë punën e administratës më efektive, zvogëlimin e shpenzimeve të fondeve publike si dhe ato të bizneseve dhe qytetarëve. Do të thotë se qytetarët dhe bizneset do të kenë procedura të thjeshtësuara përmes kryerjes së shërbimeve në një vend.

- **Zvogëlimi i pengesave administrative për dhënien e licencave dhe lejeve për bizneset.** Kjo do ndihmojë në përshpejtimin e procedurave të aplikimit dhe eliminimin e rregullave të tepërta. Do të thotë se një biznes nuk do ketë nevojë që të aplikojë për dy licenca të ndryshme kur një licencë mjafton.

- **Përmirësimi i efikasitetit dhe koordinimi i sistemit të inspektimeve shtetërore.** Kjo do të bëjë që të ulen shpenzimet për inspektime, të ulët numri i inspektimeve të panevojshme dhe arbitrare, si dhe do të bëjë që puna e institucioneve publike dhe kompanive private të jetë në përputhje me ligjin. Do të thotë se një kompani që e shkelë ligjin do ndëshkohet, ndërsa ajo që punon në përputhje me ligjin do të mbrohet prej ndëshkimeve arbitrare.

- **Vlerësimi i rregullt i politikave dhe masave rregulluese para se ato të miratohen.** Kjo do të bëjë që ligjet dhe politikat e miratuara të mos kenë pasoja të paparashikuara dhe resurset e shtetit apo investimet private të mos shpenzohen joracionalisht.

- **Kalimi prej tatimit në kufi drejt tatimit brenda Kosovës.** Shkrija e Administratës Tatimore me Doganat do të mundësojë menaxhim më efektiv, ulje të kostove operative, ulje të nivelit të informalitetit dhe favorizim të bizneseve formale. Kjo do të thotë se një biznes nuk do t'i ketë tatimet si barrë për aktivitetet e veta dhe do të përballlet me konkurrencë më të drejtë në treg.

Përmirësimi i mëtutjeshëm i ofrimit të shërbimeve për bizneset dhe qytetarët

CILA ËSHTË SFIDA? Institucionet qendrore në Kosovë ofrojnë 629 shërbime publike, ndërsa komunat rreth 100 sosh. Prej këtyre shërbimeve, rreth 575 shërbime shfrytëzohen nga bizneset gjatë punës së tyre, përfshi këtu licencat dhe lejet. Numri kaq i madh i proceseve administrative dhe i institucioneve të përfshira krijon shpenzime të larta dhe e rritë koston e të bërit biznes. Vlerësohet se kostoja që i shkaktohet bizneseve kosovare prej gjithë këtyre proceseve është 130 milion euro në vit.

CILAT JANË SHKAQET? Niveli i shkëmbimit të informatave mes institucioneve të shumta të përfshira në ofrimin e shërbimeve është shumë i ulët, teksa sistemi është i fragmentuar. Institucionet shtetërore u kërkojnë bizneseve informata që shteti tashmë i ka në dispozicion. Përjashtim përbëjnë disa shembuj pozitiv si ARBK-ja, e cila ofron më shumë se 30 shërbime përmes sistemit “one-stop-shop”. Përveç fragmentimit, nuk ekziston ndonjë politikë e unifikuar për sa i përket standardeve të cilat ofruerit e shërbimeve publike duhet t’i arrijnë, gjë që do të mundësonte integrim më të mirë të sistemeve të informimit. Nuk janë të zhvilluara sa duhet as sistemet e shërbimeve online.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH synon të përmirësojë ofrimin e shërbimeve administrative për bizneset dhe qytetarët duke integruar sistemet informative të ndërlidhura me këto shërbime. Synimi është që të krijohet një qasje horizontale ndaj shërbimeve përmes krijimit të dritareve unike të informimit, të cilat i përmbajnë të gjitha shërbimet publike të ndërlidhura me bizneset. Në këtë mënyrë, gradualisht mund të bëhet kalimi drejt ofrimit të shërbimeve online.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Krijimi i një regjistri të të gjitha shërbimeve publike, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Regjistri do të shërbejë për ndërtimin eventual të sistemeve informative të integruara mes shërbimeve të ndryshme.*
- 2) *Krijimi i një baze qendrore të të dhënave për shërbimet publike prej së cilës sistemet e ndryshme informative do të mund të nxjerrin informata, duke e eliminuar kështu nevojën që qytetarët dhe bizneset të japin informata të cilat shteti tashmë i ka në dispozicion.*
- 3) *Vendosja e një sistemi të freskimit të rregullt të informatave lidhur me ofrimin e shërbimeve brenda Ministrisë së Administratës Publike për tërë Administratën Publike.*
- 4) *Harmonizimi i mëtutjeshëm i legjislacionit për shërbimet në përputhshmëri me Direktivën e BE-së për shërbimet.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i këtyre masave do të krijojë një sistem të integruar informativ për shërbimet e administratës publike të cilat do ta përshpejtojnë punën e administratës dhe do ta zvogëlojnë koston e shërbimeve edhe për administratën, si dhe për bizneset. Ulja e koston administrative do të mundësojë kursime buxhetore ndërkohë që bizneset do të mund të kursejnë dhe t’i shfrytëzojnë paratë për operacionet e tyre të përditshme dhe për investime. Përdorimi më efikas i shpenzimeve publike dhe investimeve private do t’i japë impuls rritjes ekonomike dhe do të mundësojë zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik.

ZVOGËLIMI I PENGESAVE ADMINISTRATIVE PËR LICENCA DHE LEJE

CILA ËSHTË SFIDA? Synimi i dhënies së licencave dhe lejeve është kontrollimi i rreziqeve të pritshme të shkaktuara nga aktiviteti i biznesit, si dhe sigurimi i konkurrencës së drejtë dhe shfrytëzimi optimal i burimeve të kufizuara. Sidoqoftë, shpeshherë procedurat e licencimit pa bazë të qartë ligjore bëhen thjesht “barrë administrative”. Marrë në tërësi, institucionet e Kosovës kanë krijuar 533 procedura administrative të cilat u kushtojnë bizneseve të Kosovës rreth 130 milionë euro në vit.

CILAT JANË SHKAQET? Kosova ka numër të lartë procedurash administrative që ndërlidhen me licencat dhe lejet (rreth 66% të procedurave administrative janë të tilla). Po bëhen përpjekje për të përshpejtuar procedurat dhe për ta ulur numrin e tyre nëpërmjet Ligjit për Sistemin e Lejeve dhe Licencave dhe punës për miratimin e Ligjit për Procedura Administrative. Megjithatë nevojitet shumë punë për zbatimin e ligjeve dhe harmonizimin e sistemeve.

CILAT JANË ZGJIDHJET? Në përputhje me procesin tashmë të nisur të reformës së administratës publike, SKZH synon që të përshpejtojë dhe zvogëlojë numrin e procedurave dhe pengesave administrative nëpër të cilat bizneset duhet të kalojnë gjatë punës së tyre. Rol kyç në këtë drejtim luan thjeshtëzimi i procesit të ofrimit të shërbimit dhe ulja e numrit të licencave dhe lejeve.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Krijimi i një regjistri të të gjitha procedurave të veçanta administrative në nivelin qendror dhe lokal.*
- 2) *Vendosja e një sistemi për shqyrtimin dhe miratimin e të gjitha procedurave administrative, duke i dhënë prioritet atyre që ndërlidhen drejtpërdrejtë me bizneset.*
- 3) *Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave administrative duke filluar me fushat prioritare.*
- 4) *Adaptimi i qasjes “gijotinë” për të shkurtuar numrin dhe për të harmonizuar listën e licencave ekzistuese.*
- 5) *Zbatimi i plotë i regjistrimit online të të gjitha lejeve dhe licencave dhe sigurimi se ato që nuk janë të përfshira në regjistër do të jenë të pavlefshme.*
- 6) *Parandalimi i krijimit të kërkesave të pajustificuara për licencim, duke siguruar që ligjet sektoriale të harmonizohen me ligjin e kornizës së përgjithshme.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i këtyre masave do të ndihmojë që të ulen shpenzimet e transaksionit për bizneset. Ato gjithashtu do të ulin mundësitë për ofrim të rryshfetit apo favoreve për zyrtarët publik. Thjeshtëzimi dhe zvogëlimi i numrit të procedurave administrative do të ulë koston e të bërit biznes e për rrjedhojë do të forcojë sektorin privat, duke mundësuar rritje të investimeve dhe rritje ekonomike në vend.

PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT TË SISTEMIT TË INSPEKTIMEVE

CILA ËSHTË SFIDA? Synimi i inspektorateve është që të mbikëqyrin nëse operatorët ekonomikë i zbatojnë ligjet në fuqi. Në Kosovë për momentin i kemi 36 organe administrative që mbikëqyrin zbatimin e më shumë se 140 ligjeve, si dhe janë përgjegjëse për ndërmarrjen e inspektimeve. Megjithatë, efektshmëria e këtyre inspektorateve është shumë e ulët. Kjo bën që bizneset të operojnë pa kufizimet e nevojshme ligjore (p.sh. në raport me mjedisin, punëtorët, etj.) apo edhe që të ketë pabarazi në treg për shkak të favorizimeve në rastet e inspektimeve. E gjithë kjo e pengon klimën e të bërit biznes dhe e dëmton mirëqenien e qytetarëve.

CILAT JANË SHKAQET? Inspektoratet në Kosovë nuk ndërlidhen në një bazë të vetme ligjore funksionale, por disa prej tyre janë themeluar dhe rregulluar me legjislacionin primar të fushave të caktuara, e disa me udhëzime administrative dhe vendime. Inspektoratet aktualisht punojnë kryesisht duke pasur për tregues kryesor të suksesit arritjen e caqeve të caktuara të të hyrave, që është shtytje e gabuar për punë. Ato nuk koordinohen mirë mes vete dhe kanë funksione dhe përgjegjësi që bien ndesh me njëra-tjetrën. Inspektoratet zakonisht kanë kapacitete të ulëta njerëzore dhe administrative.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH synon të reformojë fushën e inspektimeve në Kosovë përmes krijimit të një ligji të përgjithshëm kornizë, i cili do t'i vendosë qartë udhëzimet për qartësimin e bazës ligjore të aktiviteteve të inspektimit. Po ashtu, synohet të eliminohen inspektimet e tepërta dhe do të përcaktohen standardet e përbashkëta për të tjerat, përfshi këtu formularët e standardizuar. Do të inkurajohen inspektimet e bazuara në rrezik dhe koordinimi më i mirë i procedurave inspektuese.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Miratimi i një ligji të harmonizuar lidhur me inspektimet i cili do të vendos themelet e një qasjeje të inspektimit të bazuar në rrezik.*
- 2) *Vlerësimi i të gjitha inspektimeve që bëhen sot, i pasuar me eliminimin e aktiviteteve të panevojshme ose shkrirjen e aktiviteteve inspektuese aty ku ka hapësirë.*
- 3) *Krijimi i një mekanizmi koordinues mes trupave inspektues në mënyrë që të sigurohet koordinimi më i mirë i procedurave inspektuese dhe një sistem më efektiv i mbikëqyrjes, duke e përfshirë këtu krijimin e një sistemi informativ për shkëmbimin e informatave ndërmjet inspektorateve.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i këtyre masave, së pari, do të ndihmojë në uljen e shpenzimeve administrative për inspektimet dhe alokimin e mjeteve në masa të tjera më prioritare. Së dyti, përmirësimi i efektivitetit të inspektorateve do të përmirësojë shtrebrërimet dhe eksternalitetet e tregut, dhe do të zvogëlojë ndërhyrjet e panevojshme të qeverisë në veprimtaritë e bizneseve, por edhe nivelin e korrupsionit. Ulja e barrës financiare të shtetit dhe e shpenzimeve të transaksionit për bizneset do të mundësojë nivele më të larta të investimeve publike dhe private duke rezultuar me rritje më të madhe ekonomike.

MIRATIMI I POLITIKAVE TË BAZUARA NË TË DHËNA

CILA ËSHTË SFIDA? Politikat në Kosovë shpeshherë miratohen pa u studiuar mirë efekti i tyre në praktikë. Ligjet dhe rregulloret miratohen pa i kryer paraprakisht Vlerësimet e Ndikimit Rregullativ (VNR) dhe pa u konsultuar mirë me komunitetin e biznesit. Për shkak të kësaj, ato shpeshherë nuk janë të përshtatshme për rrethanat dhe shkaktojnë pasoja të kundërta prej atyre që janë synuar. Mungesa e bazimit të politikave në të dhëna nga terreni bën që shpenzimet publike të jenë joefikase dhe të dëmtohet klima e biznesit dhe mirëqenia e qytetarëve.

CILAT JANË SHKAQET? Vlerësimet e Ndikimit Rregullativ (VNR) janë prezantuar si praktikë në vitin 2007 përmes Rregullores qeveritare nr. 01/2007, e cila më vonë është zëvendësuar me Rregulloren 09/2011. Por këto rregullore nuk janë zbatuar, kryesisht për shkak të kapaciteteve të kufizuara të ministrive që hartojnë ligjet apo edhe të shoqatave të biznesit.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH do të sigurojë që politikat dhe ligjet e miratuara të bazohen në të dhëna dhe të paraprihen në mënyrë sistematike nga Vlerësime të Ndikimit Rregullativ (VNR), në përputhje edhe me Strategjinë për Rregullim më të Mirë (2014-2020). Me një numër mesatar prej rreth njëzet ligjesh të reja të miratuara në Kuvend çdo vit, zbatimi i VNR-ve është i mundshëm. Por, në mënyrë që kjo të realizohet me sukses është e domosdoshme ngritja e kapaciteteve të agjencive qeveritare dhe sektorit privat.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Krijimi i një njësie institucionale për VNR si dhe njësi brenda ministrive të linjës. Paralelisht do të inkurajohen instrumente për dialogun publik-privat për ligjet specifike që do të ndihmojnë realizimin e VNR-ve.*
- 2) *Zbatimi i Strategjisë për Rregullim më të Mirë, përfshirë krijimin e procedurave për zbatimin e detyrueshëm të VNR-ve paraprake, përmes sistemit të koncept dokumenteve dhe memorandumeve shpjeguese të draft akteve ligjore.*
- 3) *Krijimi i një mekanizmi për mbledhjen dhe ruajtjen sistematike (databazën) të të dhënave kuantitative të nevojshme për përgatitjen e VNR-ve.*
- 4) *Përdorimi i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik dhe i komiteteve ad-hoc për analizimin e detajuar të politikave dhe legjislacionit.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i këtyre masave para së gjithash do të ndihmojë në arritjen e rezultateve më të mëdha për çdo euro të shpenzuar. Zbatimi i tyre do të çojë drejt politikave adekuate dhe rritje të efikasitetit të punës, qoftë në sektorin publik apo në atë privat. Rritja e efikasitetit dhe produktivitetit në sektorin publik dhe privat do të mundësojë aktivitet më të lartë ekonomik, pra nivele më të larta të rritjes ekonomike.

MBYLLJA E HAPËSIRAVE PËR ABUZIME NË SISTEMIN E PROKURIMIT PUBLIK

CILA ËSHTË SFIDA? Rreth 40% të shpenzimeve të buxhetit të Kosovës kalojnë përmes sistemit të prokurimit. Në vitin 2013, Agjencia Kundër Korrupsionit gjeti shkelje të rregullave të prokurimit në 1/3 të rasteve të paraqitura pranë saj. Ndërsa në po këtë vit rreth 53% të rasteve kriminale me të cilat merrej prokuroria ishin raste ku dyshohej prezenca e korrupsionit. Keqpërdorimi i parasë publike shkakton pasoja të mëdha për zhvillimin e vendit, teksa pamundëson investime të nevojshme dhe e ulë cilësinë e investimeve kapitale.

CILAT JANË SHKAQET? Baza ligjore për luftimin e korrupsionit në sistemin e prokurimit (përfshi ligjet kornizë dhe strategjitë) si dhe infrastruktura institucionale, tashmë është e krijuar. Por rregulloret aktuale duhen rishqyrtuar në mënyrë që të tejkalohen mangësitë në procedurat e prokurimit publik. Problem të veçantë përbën mungesa e informatave mbi planet e prokurimit dhe njoftimet për dhënie të kontratave, specifikimet e pakta ose të tepërta teknike, mungesa e kriterëve minimale parakualifikuese si dhe tërheqjet e papritura dhe mospërbushja e kontratave. Ndërkohë mungojnë edhe platformat e prokurimit elektronik që do të rrisnin nivelin e transparencës dhe llogaridhënies.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH do të mundësojë që puna për forcimin e sistemit të prokurimit publik të vazhdojë të jetë shtyllë e strategjisë kundër korrupsionit. Në këtë drejtim, fokusi kryesor do të jetë te mbyllja e hapësirave ligjore që mundësojnë praktika korruptive si dhe forcimi i vullnetit politik përmes miratimit të pakteve të integritetit.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Zbatimi i ligjit të ndryshuar dhe rregulloreve ekzistuese në fushën e prokurimit publik për t'i mbyllur hapësirat që mundësojnë praktika korruptive, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me transparencën, specifikimet teknike, kriteret minimale të kualifikimit dhe tërheqjet nga proceset apo mospërbushjet e zotimeve.*
- 2) *Përsheptimi i zbatimit të platformës elektronike të prokurimit publik për të gjitha kontratat, përfshi këtu zhvillimin e infrastrukturës së teknologjisë informative (TI) si dhe sistemit për menaxhimin e kontratave.*
- 3) *Miratimi i Paktit të Integritetit përmes të cilit të gjitha palët kontraktuese do të zotohen për politika jokorruptive në prokurimin publik.*
- 4) *Promovimi i Zotimit të Integritetit Korporativ përmes të cilit shoqatat e bizneseve ose OJQ-të do t'i ftojnë bizneset që vullnetarisht të miratojnë Zotimin e Integritetit Korporativ.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Mbyllja e hapësirave për praktika korruptive në sistemin e prokurimit publik do të çojë drejt uljes së korrupsionit duke rezultuar edhe me alokim më të mirë të resurseve në ekonomi. Për më tepër, ulja e nivelit të korrupsionit do të rrisë kapacitetet financiare të shtetit për të investuar në projekte kapitale dhe transfere sociale, duke kontribuar kështu në rritjen ekonomike dhe uljen e varfërisë. Ulja e nivelit të korrupsionit do të zvogëlojë edhe nivelin e përjashtimit shoqëror, sepse korrupsioni i dëmton më tepër bizneset dhe familjet e varfra, duke ua vështirësuar mundësitë konkurruese në ekonomi.

FORCIMI I SISTEMIT TË TË DREJTAVE PRONËSORE

CILA ËSHTË SFIDA? Zhvillimi ekonomik i një vendi kërkon një sistem në të cilin respektohen plotësisht të drejtat pronësore dhe ku prona është komerciale ose e tregtueshme. Zhvillimi i ulët i tregut të pronës sot ndikon negativisht në shumë sektorë të ekonomisë, duke e përfshirë bujqësinë, ku konsolidimi i tokës dhe ekonomitë përkatëse të shkallës duhet të inkurajohen në mënyrë që të rritet konkurrueshmëria. Të drejtat pronësore të pazgjidhura janë po ashtu esenciale për qasje në financa, pasi që pronat do të mund të përdoshin për kolateral.

CILAT JANË SHKAQET? Një prej problemeve kryesore mbeten informatat e paqëndrueshme kadastrale dhe joefikasiteti i gjykatave sa i përket trajtimit të rasteve të të drejtave pronësore. Në përgjithësi, edhe korniza ligjore për të drejtat pronësore nuk zbatohet plotësisht, ndërsa problem të veçantë përbënë edhe mosrespektimi i të drejtës së vajzave në trashëgimi. Në vitin 2014 vajzat dhe gratë kanë zotuar vetëm 15% të pronave të paluajtshme.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH synon që ta forcojë sistemin e të drejtave pronësore duke u fokusuar në forcimin e kornizës ligjore, promovimin e një tregu të tokës, forcimin e kapaciteteve të gjyqësorit për t'u marrë me të drejtat pronësore si dhe aktivitetet që do të sigurojnë mbrojtje më të mirë të të drejtave pronësore për grupet e marginalizuara, siç janë komunitetet jo-shumicë si dhe vajzat dhe gratë.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Zhvillimi i kornizës ligjore që përcakton qartë të drejtat dhe kushtet ligjore për të drejta të tregtueshme të pronës në pajtueshmëri me ligjet e BE-së.*
- 2) *Promovimi i tregut të tokës që mundëson rritje ekonomike, duke e përfshirë lehtësimin e konsolidimit të tokave bujqësore, si dhe hartimin dhe miratimin e planeve zhvillimore komunale dhe hartave zonale.*
- 3) *Fuqizimi i kapaciteteve dhe rolit të gjykatave për njohjen, përcaktimin dhe fuqizimin e të drejtave pronësore.*
- 4) *Sigurimi i mbrojtjes së të drejtave përkatëse pronësore të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë, si dhe garantimi dhe fuqizimi i të drejtave pronësore për gratë.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Krijimi i një sistemi më efektiv të të drejtave pronësore çon drejt krijimit të sigurisë juridike tek investitorët dhe kjo për rrjedhojë edhe i rritë mundësitë për investime, ndërkohë që u krijon qytetarëve më shumë mundësi për t'i përdorur pronat si kolateral dhe qasje në financa. Fokusi i veçantë në të drejtat pronësore të grupeve të marginalizuara do të mundësojë kohezion më të madh social. Rritja e investimeve dhe kohezioni më i madh social do të mundësojnë norma më të larta të investimeve publike dhe private.

RRITJA E EFIKASITETIT TË GJYQËSORIT NË ZGJIDHJEN E RASTEVE

CILA ËSHTË SFIDA? Sistemi gjyqësor aktualisht ka efikasitet të ulët për sa i përket shpejtësisë në zgjidhjen e rasteve, përderisa mesatarisht zgjidhja e një rasti gjyqësor merr deri 414 ditë. Ngathtësia e sistemit të drejtësisë e kufizon qasjen e qytetarëve në drejtësi dhe ua rritë ndërmarrjeve koston e të bërit biznes. Kështu, mungesa e efikasitetit të gjyqësorit e dobëson sundimin e ligjit, i kufizon investimet, e rritë informalitetin dhe kontribuon në përjashtimin e grupeve të marginalizuara nga shoqëria.

CILAT JANË SHKAQET? Sistemi gjyqësor është i stërngarkuar për shkak të rasteve të grumbulluara gjatë dekadës së fundit (446,000 në fund të vitit 2013) dhe kundërvajtjeve të lehta. Ndërrthurja në mes të funksioneve themelore dhe atyre të apelit sipas sistemit të vjetër të gjyqësorit ka çuar në rigjykime të shpeshta dhe e ka bërë rezultatin më pak të parashikueshëm, ndërkohë që ka çuar në rritje të rasteve të pazgjdhura. Kalimi në sistemin e ri që e ndan funksionin e apelit prej atij themelor e ka rregulluar këtë çështje, por ka çuar edhe në rritjen e numrit të rasteve në pritje.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH synon që të rrisë efikasitetin e sistemit gjyqësor përmes rritjes së kapaciteteve për t'i zgjidhur rastet më shpejtë dhe përmes shkarkimit të sistemit nga rastet e shumta të pazgjdhura dhe të grumbulluara. Prioritet do të jetë së pari adresimi i ngarkesës së gjykatave me numrin e madh të rasteve të lëndëve kundërvajtëse, me theks të veçantë te rastet e kundërvajtjeve në trafik, duke nxitur zgjidhjen e kundërvajtjeve jashtë sistemit gjyqësor. Së dyti, do të vijohet me zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Reduktimit të Rasteve të Pazgjdhura përmes forcimit të kapaciteteve njerëzore dhe financiare të gjykatave për t'i zgjidhur rastet e vjetra. Së treti, do të rritet norma mesatare e zgjidhjes së rasteve civile dhe penale përmes optimizimit të sistemit të menaxhimit të lëndëve dhe përdorimit më efektiv të teknologjisë informative.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Ndryshimi i kornizës ligjore në atë mënyrë që sistemi gjyqësor do të merret me kundërvajtjet vetëm nëse sanksionet janë kontestuar nga palët.*
- 2) *Stimulimi i pagesave të hershme të gjobave kundërvajtëse përmes uljes për gjobat e paguara brenda 72 orëve dhe rritjes së gjobave në rast të vonesës apo transferimit të zgjidhjes në gjykatë.*
- 3) *Shkarkimi i sistemit gjyqësor nga rastet e grumbulluara përmes krijimit të një ekipi special prej 100 personash për zvogëlimin e lëndëve të grumbulluara, të cilët brenda katër vitesh pune do të mund të zgjidhnin rastet e grumbulluara civile dhe penale duke u ndihmuar gjykatësve si hartues aktgjykimesh.*
- 4) *Ruajtja e një norme pozitive e pastrimit të rasteve të grumbulluara përmes optimizimit të sistemit të menaxhimit të rasteve dhe Sistemit të Menaxhimit të Lëndëve përmes përdorimit të Teknologjisë Informative.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Rezultati i kombinuar i masave të propozuara do të jetë një reduktim drastik i kohës së nevojshme për të zgjidhur një rast nga niveli aktual prej 414 ditëve në rreth 100 ditë. Ky efikasitet i shtuar do të ketë ndikim të konsiderueshëm në sundimin e ligjit dhe në klimën e biznesit në Kosovë si dhe do të rrisë konkurrueshmërinë e Kosovës në drejtim të tërheqjes së investimeve të huaja direkte. Për qytetarët e Kosovës kjo nënkupton mundësi më të mëdha për punësim dhe për qasje në drejtësi.

LUFTA KUNDËR INFORMALITETIT PËRMES KRIJIMIT TË NJË AGJENCIE TË VETME PËR MBLEDHJEN E TË HYRAVE

CILA ËSHTË SFIDA? Niveli i informalitetit në Kosovë mbetet i lartë, gjë që ka pasoja të mëdha në të ardhurat e buxhetit. Vlerësohet se informaliteti në Kosovë është rreth 26-34% të GDP-së. Të ardhurat që mbesin pa u tatuar zvogëlojnë mundësitë e shtetit për të investuar në fushat prioritare për zhvillim. Gjithashtu, informaliteti dhe mungesa e respektimit të ligjit favorizon bizneset e padrejta dhe jo-inovative, duke e dëmtuar kështu konkurrencën e ndershme dhe zhvillimin e sektorit privat.

CILAT JANË SHKAQET? Sistemi aktual i të hyrave është kryesisht i varur nga të ardhurat e mbledhura në kufi. Një tranzicion gradual në të hyrat e brendshme është i nevojshëm për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm fiskal. Sipas vlerësimit të fundit të Bankës Botërore lidhur me hendekun e taksave, niveli i hendekut vetëm në rastin e TVSH-së llogaritet të jetë 34%. Kapacitetet e Administratës Tatimore të Kosovës për të mbledhur tatime brenda Kosovës janë të kufizuara.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH do të rrisë potencialin për rritjen e të ardhurave të brendshme duke i shkrirë Doganat e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës në një njësi të vetme administrative për mbledhjen e unifikuar të tatimeve dhe taksave doganore. Kjo do të bëhet në kontekst të uljes së të hyrave të doganës për shkak të marrëveshjeve preferenciale me CEFTA dhe MSA. Numri relativisht i ulët i personelit në ATK dhe Dogana dhe fakti se janë organizata të reja do ta bëjë procesin e shkrirjes më të lehtë.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Bashkëpunimi ndër-institucional për të arritur konvergjencën graduale të proceseve dhe integrimin pasues të dy institucioneve. Identifikimi i proceseve identike, të ngjashme dhe ato të veçanta. Optimizimi i proceseve të mbledhjes së taksave duke i minimizuar burimet, eliminuar humbjet e fondeve dhe kursyer kohën. Më pas, ndryshimet e nevojshme ligjore për krijimin e administratës së unifikuar të mbledhjes së të hyrave. Procesi i shkrirjes së të dy institucioneve do t'i nënshtrohet një periudhe kalimtare, në mënyrë që organizatat të përgatiten për bashkim dhe të harmonizojnë proceset përkatëse.*
- 2) *Themelimi i Agjencisë për mbledhjen e të hyrave. Hartimi i ligjit për themelimin e Agjencisë për mbledhjen e të hyrave, hartimi i planit të veprimit për funksionimin e agjencisë, si dhe kompletimi i operacionalizimit të Agjencisë për mbledhjen e të hyrave të Kosovës.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Rritja e të ardhurave në buxhet do të mundësojë investime në fusha prioritare për zhvillim. Shkrirja e administratës së të dy institucioneve do të eliminojë punët e dyfishta e kështu do t'i ulë kostot operative. Ulja e informalitetit do të përmirësojë konkurrencën në treg duke e bërë atë më të drejtë dhe duke stimuluar rritjen e bizneseve formale dhe më inovative. Të gjitha këto do të krijojnë kushte më të mira për investime dhe për rritje ekonomike.



INDUSTRIE KONKURRENZE

Pse industrinë konkurruese?

Një ekonomi e tregut është më efikase dhe e aftë për të gjeneruar rritje ekonomike nëse shteti ndërhyr sa më pak tek ndërmarrjet private. Por, roli i shtetit është i pashmangshëm për të stimuluar krijimin e ndërmarrjeve konkurruese në sektorët me vlerë të lartë të shtuar. Industrinë e tilla bëjnë që rritja ekonomike të prodhojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. E ardhmja e zhvillimit të Kosovës varet nga fushëveprimi dhe produktiviteti i ndërmarrjeve. Duhet inkurajuar krijimi, qëndrueshmëria dhe produktiviteti i ndërmarrjeve private lokale si dhe tërheqja e investimeve të huaja. Kosova tashmë ka arritur të konsiderueshme në këtë fushë, në veçanti renditja në raportin e "Të Bërit Biznes". Në anën tjetër, kjo nuk është e mjaftueshme. Prandaj, ne duhet të vazhdojmë tutje duke përkrahur në vazhdimësi ndërmarrësit e rinj, ndërmarrjet ekzistuese, si dhe investitorët potencial nga jashtë. Është e domosdoshme një qasje e re dhe inovative në ndërhyrjet e shtetit të cilat do t'i mundësonin bizneseve të zhvillohen në mënyrë më solide dhe me qasje më të mirë në financa. Prandaj, duhet të ndërhyhet vetëm në fushat në të cilat tregu vetvetiu nuk mund t'i zgjidhë pengesat e tij për zhvillim me qëllim të inkurajimit të zhvillimit të sektorit privat që konsiderohet fundament për këtë shtyllë.

Ndërhyrjet e SKZH?

- **Lehtësimi i qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare.** Kjo do të mundësojë rritjen e nivelit të kreditimit për ndërmarrjet prodhuese, rritje të nivelit të investimeve, rritje të punësimit dhe ulje të deficitit tregtar. Do të thotë se një ndërmarrje do të ketë mundësi të marrë kredi me normë më të ulët interesi dhe kërkesë më të vogël për kolateral përmes mekanizmit të garantimit të kredive.
- **Mbështetja në lidhjet ndërmjet ndërmarrjeve në grupime industriale të përafërta.** Kjo do të ndihmojë në forcimin e lidhjeve ndërmjet industrive, krijimin e ndërmarrjeve të reja të mbështetura mbi ato të vjetrat, si dhe inovacionin përmes lidhjes me punën kërkimore. Do të thotë se një biznes do të prodhojë apo të shërbejë diçka të re nga informatat që i përfiton prej këtij grupimi.
- **Përmirësimi i standardeve të cilësisë dhe kalimi në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar.** Kjo do të bëjë që bizneset të mund të prodhojnë produkte më të sofistikuar dhe më të shtrenjta, të përshtatshme për eksport, duke i rritur të ardhurat për vete dhe për ekonominë. Do të thotë se një përpunues rrobash do merret edhe me dizajnin e tyre dhe do të shtojë vlerë.
- **Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës.** Kjo do të bëjë që ekonomia e Kosovës t'i mbulojë nevojat e saj për financim, të sigurojë transferim të teknologjisë dhe aftësive, dhe të ulë deficitin tregtar. Do të thotë se një biznes i huaj apo nga diaspora do të gjejë mbështetje konkrete prej shtetit për të investuar në Kosovë.
- **Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara.** Kjo do të ndihmojë në rritjen e madhësisë mesatare të fermave dhe sipërfaqes së parcelave, si dhe në rritjen e prodhimtarisë bujqësore për shkak të ekonomisë së shkallës. Kjo do të thotë se bujqit do të mund të prodhojnë më shumë dhe industria agro-përpunuese të ketë më shumë lëndë të parë vendore.
- **Lehtësimi i përdorimit të potencialit mineral të Kosovës në funksion të zhvillimit ekonomik.** Kjo do të mundësojë rritjen e ndërmarrjeve ekzistuese dhe krijimin e ndërmarrjeve të reja që do të mundësojnë rritje më të madhe ekonomike. Do të thotë se një kompani do ta ketë më të lehtë që të kërkojë burime minerale dhe të zhvillojë projekte.
- **Rivitalizimi i plotë i Trepçës.** Kjo do ta ulë deficitin tregtar të Kosovës, do të gjenerojë të ardhura dhe do të ketë ndikim pozitiv në shumë industri të tjera.
- **Investimi i mjeteve të Fondit të Privatizimit në asete strategjike të ekonomisë.** Kjo do të bëjë që mjetet prej ish-aseteve shtetërore të shkojnë për asete të reja.
- **Rritet efektiviteti i ndërmarrjeve në pronësi shtetërore.** Kjo do të mundësojë rritjen e kontributit të tyre në ekonomi, rritjen e vlerës së tyre dhe rritjen e të ardhurave për buxhetin e shtetit. Do të thotë se ndërmarrjet e shtetit, do të gjenerojnë më shumë fitime që më pas do t'i kthehen shoqërisë.

RRITJA E QASJES NË FINANCA PËR NDËRMARRJET KOSOVARE

CILA ËSHTË SFIDA? Një nga pengesat kryesore për investimet e sektorit privat në Kosovë është qasja në financa. Rreth 40% të firmave e identifikojnë qasjen në financa si një pengesë të madhe. Një numër i madh i NVM-ve nuk mund të plotësojnë kriterin për kolateral për të marrë kredi bankare.

CILAT JANË SHKAQET? Kosova është duke e krijuar Fondin për Garantimin e Kredive i cili do të mbulojë një përqindje të caktuar të vlerës së kryegjësë së kredisë, kështu që kjo do të ndihmojë në zbutjen e problemit. Në anën tjetër, sistemi i regjistrimit të kredive në Kosovë funksionon mirë, por mbulimi është i kufizuar në vetëm 22% të popullsisë së rritur (në krahasim me mesataren e OECD prej 43%). Kjo ndikon në aftësinë e sistemit për të shërbyer si një ofrues gjithëpërfshirës i informatave financiare për industrinë bankare. Mbulimi dhe cilësia e informacionit është vendimtare që ky i fundit të vlerësojë siç duhet “margjinën e rrezikut”, e cila shtohet mbi normën bazë për të llogaritur normën e interesit të përgjithshëm. Gjithashtu, firmat në Kosovë kanë kapacitete të dobëta për të raportuar të dhënat e tyre financiare, që rezultojnë me kërkesa të larta për kolateral dhe norma të larta interesi.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH do të rrisë qasjen e ndërmarrjeve kosovare në financa duke e siguruar garantimin e kredive, uljen e normave të interesit, përmirësimin e sistemi të informatave financiare, si dhe ofrimin e shërbimeve të këshillimit për arritjen e standardeve korporative të raportimit financiar, që ato do t'i ndihmojë në rastet e aplikimit për kredi.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Operacionalizimi i skemave për garantimin e kredive sipas dizajnit të tanishëm (duke siguruar menaxhim transparent) si dhe duke i marrë në konsideratë prioritetet sektoriale nga dokumenti për Politikën e Sektorit Industrial.*
- 2) *Vlerësimi i operimit të skemës dhe shqyrtimi i mundësive për zgjerim të mëtejshëm dhe optimizim të skemës. Kjo përfshin gjetjen e burimeve të tjera të kapitalizimit për të rritur shumën e kapitalit të investuar.*
- 3) *Integrimi i bazës së të dhënave të sistemit të regjistrimit të kredive me administratën tatimore, kompaninë publike dhe me regjistrin e bizneseve, në mënyrë që të përmirësohen informatat përmes të cilave vlerësohet risku i kredive.*
- 4) *Krijimi i lehtësirave speciale për Skemën Voucher të MTL-së për të financuar azhurnimin e standardeve korporative të raportimit për firmat. Kjo do t'u ndihmojë firmave për të pasur vlerësim më pozitiv të riskut në rastet e aplikimit për kredi.*
- 5) *Zhvillimi i tregut të sigurimeve dhe integrimi i tyre në tregje rajonale me qëllim të zvogëlimit të rrezikut përmes diversifikimit.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Koncepti i dokumentit për Skemën e Garantimit të Kredive vlerëson që rritja e huadhënies do të krijojë qarkullim të ri inkremental prej 1 miliardë Eurosh në gjashtë vitet e para të veprimtarisë. Pjesa më e madhe e këtij qarkullimi do të vijë nga prodhimtaria vendore, duke përmirësuar kështu edhe bilancin tregtar. Këto shitje apo ky qarkullim do të mund të rezultonte me rreth 10 milionë Euro në të ardhura nga tatimet në të hyra të korporatave. Vendet e reja të punës do të mund të krijonin rreth 12 milionë Euro në kontribute pensionale. Fondi i Garancive do të mbështesë 4,150 kredi të reja për NVM-të në shumë prej 360 milion Euro, duke krijuar 20,000 vende pune. Raporti i kredi-dhënies nga sektori bankar për sektorin privat, si përqindje e BPV-së, do të rritet në së paku 40% nga mesatarja aktuale prej 33.5%) deri në vitin 2021. Shpërndarja e normës së interesit do të ulët në nivelin e mesatares rajonale.

RRJETËZIMI DHE ZHVILLIMI I NDËRMARRJEVE TË GRUJUARA

CILA ËSHTË SFIDA? Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) përfitojnë nga bashkëpunimi dhe organizimi në grupime (clusters) – ku bizneset e llojit të përafërt dhe institucionet kërkimore dhe arsimore punojnë afër njëri-tjetrës, për shkak të përmirësimit të efikasitetit dhe përhapjes së njohurive. Të dhënat nga shtetet e tjera në zhvillim dëshmojnë se NVM-të e grumbulluara në kllasterë kanë rritje më të madhe dhe zhvillim më inovativ. Rrjedhimisht, rajonet me kllasterë tërheqin më shumë biznese të reja që lidhen me zinxhirët e vlerës që krijohen brenda grupimeve.

CILAT JANË SHKAQET? Ekzistojnë një varg pengesash për zhvillimin e grupimeve industriale në Kosovë. Këto pengesa përfshijnë bashkëpunimin e dobët në mes të firmave, lidhjet e dobëta në mes të NVM-ve dhe institucioneve kërkimore, por edhe mungesa e fuqisë punëtore profesionale që do t'i avanconte aktivitetet e firmave në zinxhirin e vlerës. Deri më tani nuk ka pasur mekanizma institucionalë të cilët do të stimulonin bashkëpunimin mes firmave dhe organizimin e tyre në grupime.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH do të adresojë mungesën e lidhshmërisë dhe grupimeve mes firmave duke e lehtësuar rrjetëzimin mes tyre si dhe duke ofruar asistencë të drejtpërdrejtë (përmes granteve dhe asistencës teknike). Kjo do të bëhet përmes krijimit të mekanizmave konkret mes qeverisë dhe bizneseve që do ta stimulojnë bashkëpunimin ndërmjet aktorëve në zinxhirët e vlerës.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Zhvillimi i një Strategjie Kombëtare të Konkurrueshmërisë e cila do t'i identifikojë intervenimet strategjike për rritjen e konkurrueshmërisë së NVM-ve. Do të identifikohen shtatë grupime konkurruese dhe funksionale të cilat do të mbështeten përmes formave konkrete (granteve, asistencës teknike, et). Kjo mbështetje do të ofrohet përmes Fondit të Investimeve dhe Punësimit, më konkretisht përmes Skemës për Konkurrueshmërinë e NVM-ve apo skemës tematike për Rritjen e Inovacionit në Sektorin e TI-së.*
- 2) *Krijimi i një kornize institucionale në mbështetje të zhvillimit të grupimeve industriale me përfshirjen e qeverisë dhe bizneseve, përfshi këtu Shoqatat e Grupimeve, ku firmat më të mëdha do të jenë prijëse. Qeveria bashkë me shoqatat mund të lehtësojë dhe ndihmojë përfshirjen e NVM-ve për t'u bërë furnizuese të firmave të mëdha në grupim.*
- 3) *Krijimi i rrjetit të furnizuesve dhe nën-kontraktorëve përmes organizimit të rregullt të takimeve mes qeverisë dhe bizneseve, në mënyrë që të mund të krijohen dhe forcohen lidhjet në zinxhirët e vlerës.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i kësaj mase do të mundësojë rritjen e ndërlidhjes ndërmjet ndërmarrjeve në zinxhirë të vlerës dhe pjesëmarrjen më të lartë të sektorit industrial në BPV. Bashkëpunimi ndërmjet firmave do të krijojë sinergji, rritje të inovacionit dhe do të mundësojë rritjen e industrive të reja të mbështetura mbi aktivitetet e firmave që janë pjesë e grupimeve. Nën-kontraktimi dhe specializimi i firmave në aktivitete specifike do t'ju mundësojë firmave të mëdha që të fokusohen në inovacion dhe kalim në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar, gjë që do t'i rrisë të ardhurat në ekonomi.

KALIMI I NVM-ve NË AKTIVITETE ME VLERË MË TË LARTË TË SHTUAR

CILA ËSHTË SFIDA? Për momentin, sektori i NVM-ve në Kosovë është i dobët dhe jokonkurrues qoftë në tregun vendor apo ndërkombëtar, i dominuar nga shitja me pakicë, kështu që nuk është në gjendje që të bëhet një motor i rritjes duke i zëvendësuar importet dhe duke u angazhuar në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar. Pasoja e kësaj është deficit i lartë tregtar, me raportin eksport-import prej 12% dhe rritja më e ulët vjetore e BPV-së.

CILAT JANË SHKAQET? Shumica e NVM-ve në Kosovë, veçanërisht ato në sektorët prodhues, nuk arrijnë që t'i përmbushin standardet e cilësisë, qoftë për shkak të kostos së investimeve të nevojshme për arritjen e tyre apo për shkak të kostos së certifikimit. Pengesë është edhe mungesa e shërbimeve këshilluese. Infrastruktura e cilësisë dhe certifikimit është vendimtare për konkurrencën në një treg global. Shpenzimet e ulëta publike për kërkim dhe zhvillim (vetëm 0.1% të BPV-së) si dhe mungesa e një infrastrukture koherente të inovacionit e dëmton zhvillimin e NVM-ve. Mungesa e stimujve financiar dhe, për disa sektorë, e sistemeve të informacionit mbi tregjet, e pamundëson përdorimin e potencialit njerëzor dhe kapital të vendit.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH do të ndihmojë NVM-të në përmirësimin e standardeve të cilësisë, krijimin e një skeme për mbështetjen e inovacionit dhe shërbimeve këshillimore, si dhe mbështetjen specifike për sektorët e bujqësisë dhe teknologjisë së informacionit.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) Krijimi i një instrumenti për të ndihmuar në certifikimin e standardeve të cilësisë për ndërmarrjet kosovare. MTI do ta krijojë këtë instrument i cili do t'i përkrahë NVM-të që janë të orientuara drejt eksportit si dhe ato që janë të angazhuara në sektorët e mallrave të tregtueshme.
- 2) Krijimi i një skeme për mbështetjen e inovacionit e cila do të sigurojë stimuj (grante korrespondente) për investimet e NVM-ve në hulumtime dhe kërkime shkencore. Kjo skemë do të jetë pjesë e Fondit të Punësimit dhe Zhvillimit. Ministria e Financave gjithashtu do të sigurojë përjashtime tatimore për blerjet e reja të teknologjisë që nxisin lidhjet me institucionet kërkimore jashtë vendit.
- 3) Krijimi i platformës informative të Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor për ta rritur konkurrueshmërinë në sektorin e bujqësisë. Kjo e përfshin rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave Bujqësore (FADN), regjistrin elektronik të fermerëve (EFR), sistemin e identifikimit të parcelave të tokës (LPIS) dhe Sistemin e Integruar të Administrimit dhe Kontrollit Bujqësor (IACS).
- 4) Krijimi i një fondi për subvencionimin e projekteve të inovacionit në fushën e teknologjisë informative (TIK). Ky fond do të jetë pjesë e Fondit të Punësimit dhe Zhvillimit.
- 5) Zhvillimi i shërbimit këshillimor për biznese në pesë rajone ekonomike dhe sigurimi i paketës cilësore, të efektshme dhe standarde të ShKB-së. Kjo do të bëhet përmes një ombrelle të unifikuar të shërbimeve këshilluese të biznesit të ofruara në nivel rajonal, nëpërmjet Agjencive të Zhvillimit Rajonal (AZHR). Ato do të ofrojnë një paketë të shërbimeve përkrahëse, si hulumtimin e tregut, menaxhimin financiar, studimet e fizibilitetit, strategjitë e shitjes dhe shpërndarjes, etj.

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i kësaj mase do ta rrisë konkurrueshmërinë e NVM-ve kosovare dhe kalimin e tyre në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar, duke çuar kështu drejt zvogëlimit të deficitit tregtar, rritjes së të ardhurave në ekonomi, e kështu duke mundësuar rritje të qëndrueshme ekonomike.

PROMOVIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE (IHD) DHE RITJIA E ROLIT TË DIASPORËS NË ZHVILLIMIN EKONOMIK

CILA ËSHTË SFIDA? Kosova ka nevojë të madhe për financim të jashtëm për t'i adresuar nevojat e ekonomisë së saj. Të hyrat vjetore mesatare të IHD-së në Kosovë gjatë periudhës 2009-2013 kanë qenë 400 milionë Euro, që është shumë e pamjaftueshme për të siguruar rritje të dëshiruar ekonomike. Në anën tjetër, edhe investimet e diasporës, përkundër faktit se janë të konsiderueshme, janë të orientuara kryesisht drejt sektorëve si ndërtimi dhe pronat e paluajtshme, e shumë pak drejt sektorëve prodhues.

CILAT JANË SHKAQET? Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA) aktualisht nuk i ka kapacitetet e nevojshme për të promovuar në mënyrë efektive potencialin e investimeve në vend. Mungon një qasje më agresive dhe proaktive në tërheqjen e investitorëve, duke ofruar shërbime të paketuara më mirë apo edhe stimuj konkret. Përveç kësaj, nuk ekzistojnë skema të përkrahjes specifike për diasporën që i lehtësojnë investimet ose i zgjidhin çështjet e rrezikut financiar, apo që e adresojnë çështjen e mungesës së informatave për mundësitë e investimeve.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH do të stimulojë rritjen e investimeve të huaja direkte duke forcuar kapacitetet e KIESA-s, duke e ndryshuar kulturën e shërbimit si dhe duke ofruar stimuj për investitorët strategjikë. Në anën tjetër, do të zhvillohet një skemë për stimulimin e investimeve të diasporës, në formën e granteve korrespondente.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Fuqizimi i kapaciteteve të KIESA dhe riorganizimi. Krijimi i një ekipe me përvojë të gjerë në sektorin privat për zhvillim të produkteve, paketim, para-kualifikim, prezantim, shitje, kujdes pas shitjes, dhe menaxhim të klientëve. Hartimi i strategjisë së re për IHD e cila ofron pako të diferencuara të stimulimit. KIESA gjithashtu do të vendosë përfaqësues tregtarë në ambasadat e Kosovës dhe do të krijojë skema të bonuseve të orientuara drejt shërbimeve që tërheqin investitorët e huaj.*
- 2) *Mbështetja e investimeve të investitorëve strategjik përmes stimujve dhe negociimit të drejtpërdrejtë, të ofruar përmes Ligjit për Investime Strategjike.*
- 3) *Krijimi i skemave të granteve korrespondente për diasporën. Përmes kësaj skeme pjesëtarët e diasporës që bëjnë investime kapitale në një biznes të ri apo ekzistues (me plan të mirëfilltë biznesi) do t'u mbulohet pjesa tjetër e investimit përmes grantit. Skema do të fillojë me pilot projekt në sektorin e bujqësisë dhe të shërbimeve në fushën e IT-së.*
- 4) *Aktivizimi dhe zgjerimi i rrjeteve të bizneseve të diasporës në funksion të rritjes së investimeve nga diaspora në Kosovë.*
- 5) *Bashkëpunimi në mes të rrjeteve të bizneseve të diasporës si dhe institucioneve të vendit (MTI, MeD, KIESA, odat ekonomike) në funksion të plasimit të produkteve të Kosovës në tregun evropian dhe atë botëror edhe duke u bazuar fillimisht në diasporën tonë si konsumatorin e parë, si mënyrë për të promovuar eksportet e Kosovës.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Rritja e IHD drejt sektorëve produktivë do t'i ndihmonte ekonomisë së Kosovës për të mbuluar mungesat e financimit dhe për të siguruar transferimin e teknologjisë dhe aftësive. Kjo nga ana tjetër do të ndihmonte në procesin e rivitalizimit të sektorit industrial të Kosovës dhe zvogëlimin e deficitit tregtar. Rritja e investimeve të diasporës do ta kthejë atë në motor të rritjes së orientuar kah eksportet, rritjes së aftësive të fuqisë punëtore dhe lidhjes me zinxhirët globalë të vlerave. Një qasje e fokusuar mund ta shndërrojë rolin e diasporës nga ajo e një shpëtimtareje financiare që mbështet nevojat themelore të konsumit, në një shtyllë të zhvillimit afatgjatë dhe të qëndrueshëm.

RREGULLIMI I TOKAVE BUJQËSORE

CILA ËSHTË SFIDA? Kosova ka prodhimtari bujqësore jokonkurruese dhe bazë të ulët të prodhimit, e cila nuk është e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e brendshme, qoftë të konsumatorëve apo industrisë agro-përpunuese. Bujqësia luan rol të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës për shkak të shtrirjes rurale të popullsisë dhe mundësive që krijon për gjenerimin e të ardhurave. Por ajo sot është nën-potencial prandaj edhe duhet të bëhet rregullimi dhe konsolidimi i tokave bujqësore.

CILAT JANË SHKAQET? Pengesa kryesore për zhvillimin e bujqësisë është sipërfaqja e vogël e tokës bujqësore të ekonomive familjare, parcelat e fragmentuara dhe të shpërndara, si dhe mungesa e dokumenteve pronësore. Kjo vlen edhe në ato zona kadastrale në të cilat janë zhvilluar projektet e komasacionit të papërfunduar plotësisht, të realizuar në vitet 1983-1989. Madhësia mesatare e parcelave në vend llogaritet të jetë 0.3 hektarë. Kjo pamundëson krijimin e ekonomive të shkallës.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH do të adresojë çështjen e fragmentimit të tokave bujqësore, duke e bërë grupimin dhe krijimin e parcelave më të mëdha dhe të konsoliduara, me qëllim të rritjes së sipërfaqeve minimale të tyre dhe rritjes së madhësisë mesatare të fermave. Po ashtu do të punohet në zgjidhjen e çështjeve pronësore juridike të pjesëmarrësve në komasacionin e papërfunduar të tokës, si dhe regjistrimin e pronarëve në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Përgatitja dhe financimi i projektit të rregullimit të tokës dhe integrimi në projektet e zhvillimit rural.*
- 2) *Ndërmarrja e reformave strukturore (me theks në masa ligjore dhe institucionale) me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për rritjen e prodhimtarisë bujqësore.*
- 3) *Krijimi i ngastrave në formë sa më të rregullt gjeometrike, të përshtatshme për përdorim të lehtë të mekanizmit bujqësorë, si dhe do të realizohet projekti i Sistemit të Identifikimit të Parcelave (LPIS).*
- 4) *Formimi i rrjetit të rrugëve fushore, që mundësojnë qasje të drejtpërdrejtë në parcela, si dhe eliminimi i servitutit sezonal – qasje në pronë përmes pronës së dikujt tjetër.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i këtyre masave do të ndihmojë në rritjen e madhësisë mesatare të fermave dhe sipërfaqes mesatare të parcelave, në rritjen e prodhimtarisë bujqësore; rritjen e konkurrueshmërisë; zhvillimin e tregut të tokës, si parakusht i rëndësishëm për ekonominë e tregut të lirë; krijimin e mundësive për investime afatgjata në këto prona; zbatimin e Planeve Zhvillimore Komunale; si dhe shpërndarjen e drejtë të projekteve investuese të zhvillimit rural dhe subvencioneve nga buxheti i shtetit për pronarët dhe shfrytëzimin e këtyre pronave. E gjithë kjo do të ndihmojë në rritjen e prodhimit bujqësor dhe norma më të larta të rritjes ekonomike dhe punësimit në vend.

SHFRYTËZIMI I POTENCIALIT MINERAL TË KOSOVËS

CILA ËSHTË SFIDA? Qasja në burimet natyrore është një ndër faktorët kryesorë për sjelljen e investimeve të huaja direkte (IHD). Zhvillimi dhe hulumtimi i minierave ekzistuese në Kosovë dhe hapja e atyre të reja është një mundësi për të rritur punësimin dhe standardet e jetesës, për të mundësuar krijimin e industrive dhe për të rritur PVB-në dhe eksportet. Vlera e mineraleve të Kosovës vlerësohet diku mes 12.5 dhe 25 miliardë EUR. Megjithatë, këto burime nuk janë shfrytëzuar sa duhet për të shërbyer si burim i rritjes ekonomike.

CILAT JANË SHKAQET? Ekzistojnë disa pengesa të mëdha për të shfrytëzuar plotësisht potencialin mineral të Kosovës. Një nga ato më të shquarat është nevoja për zgjidhjen e të drejtave pronësore të cilat pamundësojnë hulumtimet potenciale. Faktorët e tjerë kryesorë që ndikojnë në hulumtime dhe zhvillime janë siguria e licencave dhe lejeve, mungesa e konsistencës në politikat minerare dhe stabiliteti i kushteve eksploruese, të gjitha këto të lidhura me administrimin. Krijimi i industrive me bazë në burimet minerale pengohet edhe nga mungesa e mekanizmave që do të mundësonin lidhje ndër-sektoriale mes punës kërkimore dhe industrive të ndryshme në zinxhirët e vlerës.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKHZ do të mundësojë shfrytëzimin optimal të potencialit mineral të Kosovës në funksion të zhvillimit ekonomik, përmes zgjidhjes së problemeve strukturore të pronësisë mbi burimet natyrore, adresimit të mangësive në rregullimin e tregut dhe kapaciteteve administrative, lidhjen e minierave me industrinë dhe adoptimin e një qasjeje ndër-sektoriale, si dhe përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse. Një pjesë e këtyre masave, sidomos ato që kanë të bëjnë me financim të drejtpërdrejtë, mund të mbështeten përmes Fondit të Zhvillimit dhe Punësimit, apo edhe përmes stimujve që do të përcaktohen në Ligjin për Investimet Strategjike.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Krijimi i modaliteteve institucionale për të mbështetur (përmes financimit apo asistencës teknike) projekte të reja strategjike në sektorin mineral, në veçanti ato që do të mund të gjeneronin punësim, krijim industrish përpunuese përmes lidhjes me zinxhirët e vlerës, si dhe eksport drejt tregjeve të huaja.*
- 2) *Mbështetja e programeve kërkimore gjeologjike dhe minerare, krijimi i modaliteteve për zgjidhjen e çështjeve pronësore si dhe ndërtimin e një sistemi informativ për përcjelljen e zhvillimeve në sektorin mineral.*
- 3) *Rregullimi i tregut të kërkimeve dhe zhvillimit të projekteve përmes forcimit të kapaciteteve administrative të organeve mbikëqyrëse dhe agjencive ekzekutive. Procedurat dhe politikat rregulluese të sektorit do të shqyrtohen në mënyrë që të krijohet qartësi dhe qasje lehtësuese për investitorët dhe operatorët ekonomik.*
- 4) *Ofrimi i mbështetjes për të zhvilluar infrastrukturën përcjellëse për sektorin mineral, duke përfshirë atë të transportit dhe energjisë.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Kërkimi dhe përdorimi i burimeve minerale të Kosovës do të mundësojë rritjen e produktivitetit dhe të ardhurave në ekonomi, duke krijuar industri të reja dhe duke krijuar vende të reja pune. Rritja e investimeve në sektorin mineral dhe të ardhurat shtesë në sektorin e industrisë do të mundësojnë normë më të lartë të rritjes ekonomike dhe zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik dhe social.

RISTRUKTURIMI DHE RIVITALIZIMI I TREPÇËS

CILA ËSHTË SFIDA? Trepça sot operon me dy njësi të ndara dhe vetëm 29% të kapacitetit të saj të dikurshëm. Dikur kjo ndërmarrje ishte gjiganti industrial i Kosovës dhe punësonte rreth 23,000 persona. Rivitalizimi i saj do të luante rol shumë të rëndësishëm për uljen e deficitit tregtar, rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës, sidomos në rajonin e Mitrovicës.

CILAT JANË SHKAQET? Kompania vuan nga teknologjia e vjetruar dhe mungesa e investimeve në fuqinë punëtore. Aktualisht ajo funksionon si Trepça e veriut dhe ajo e jugut, dy njësi autonome, secila me organe të ndara të menaxhimit, nën Administrimin e AKP-së. Njësitë veprojnë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra, përfshirë shitjet, prokurimin, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financave. Problemi më i madh për ristrukturimin e kompanisë dhe rivitalizimin e saj janë grumbullimi i kërkesave të kreditorëve (rreth 14,000 kërkesa të pranvara nga Dhoma e Veçantë). Ristrukturimi është një proces shumë kompleks për shkak të detyrimeve ligjore që Kosova nuk i ka marrë përsipër me vullnetin e saj.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH synon që ndërmarrjet strategjike si Trepça të mund të operojnë në kapacitet të plotë dhe kështu të kthehen në faktor të rëndësishëm të punësimit, prodhimit dhe eksporteve. Një zgjidhje e mundshme është bartja e detyrimeve tek një entitet tjetër juridik në mënyrë që pjesa e qëndrueshme e biznesit të mund të rivitalizohet.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Konsolidimi i analizave të deritanishme që dërgojnë në analizën finale të fizibilitetit (duke përfshirë vlerësimin e asetëve dhe përgjegjësi/detyrimeve të Trepçës si edhe valorizimin e rezervave minerale) përmes ekspertizës vendore dhe ndërkombëtare.*
- 2) *Hartimi i koncept dokumentit i bazuar në studimin e fizibilitetit me të cilin do të vendoseshin parimet e përgjithshme rreth rregullimit ligjor të Trepçës. Më tej, në bazë të koncept dokumentit të hartohet dhe miratohet ligji për rregullimin e statusit ligjor të Trepçës si ndërmarrje me më shumë se një person juridik.*
- 3) *Në përputhje me studimin e fizibilitetit, të rregullohen çështjet rreth asetëve dhe bizneseve të paqëndrueshme për rivitalizim, përderisa do të identifikohet entiteti i veçantë për të marrë përsipër përgjegjësitë/detyrimet ose të adresohen çështjet lidhur me borxhet e vjetra të Trepçës.*
- 4) *Vendosja për rritjen e afarizmit/prodhimit industrial të mëtejme të Trepçës duke u mbështetur në alternativën më të arsyeshme ekonomike, teknologjike, sociale dhe mjedisore.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Duke e supozuar një rritje të të hyrave prej 20% pas pesë vitesh, vlera nominale e të hyrave vjetore do të arrihte në 39 milionë Euro, gjë që do t'i mundësonte Trepçës investime në prodhim derisa të arrihet vlera maksimale e prodhimit. Rivitalizimi i Trepçës do të zvogëlojë deficitin tregtar të Kosovës, do të gjenerojë të ardhura për buxhetin e shtetit, si dhe do të ketë ndikim pozitiv në shumë industri të tjera në Kosovë, duke i dhënë kështu shtytje rritjes ekonomike të vendit.

ZHBLOKIMI I FONDIT TË PRIVATIZIMIT DHE PËRDORIMI I MJETEVE PËR ZHVILLIM

CILA ËSHTË SFIDA? Shitja ose likuidimi i ndërmarrjeve shtetërore që nisi në periudhën e pasluftës ka bërë që shteti të mund të akumulojë 656 milionë Euro. Rreth 300 milionë prej këtyre mjeteve mund të përdoren për investime kapitale në asete strategjike. Institucionet qeveritare vazhdojnë të marrin kredi nga institucione ndërkombëtare si FMN, BB, BERZH, ndërkohë që fondi i privatizimit ka mbetur i ngrirë në BQK. Në një kohë kur Kosova ka shumë nevoja për investime, është më se e arsyeshme që të gjinden mënyrat se si fondet prej aseteve të së shkuarës të përdoren për ndërtimin e aseteve t e së ardhmes.

CILAT JANË SHKAQET? Dispozitat ligjore e detyrojnë qeverinë që të mbajë fondet në një trust të ndarë dhe të investojë vetëm në instrumente financiare të sigurta, meqenëse ato mendohet se janë një rezervë për kompensimin potencial të kërkesave të kreditorëve nga procesi i privatizimit. Megjithatë, ekzistojnë mënyra të ndryshme se si këto mjete mund të shfrytëzohen.

CILA ËSHTË ZGJIDHJA? SKZH synon që të zhbllokojë fondin e privatizimit dhe t'i përdorë mjetet e liruara për nevojat e zhvillimit ekonomik të vendit, apo më konkretisht, për nisma që synojnë ta forcojnë ndërmarrësinë dhe industrinë në Kosovë. Synimi është që mjetet prej ish-ndërmarrjeve publike të investohen sipas parimit të “zëvendësimit të asetit me aset”.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Vlerësim i pavarur i mjeteve në dispozicion duke i marrë në konsideratë kërkesat e kreditorëve dhe detyrimet e tjera, si dhe marrja e një vendimi strategjik se për çfarë do të përdoren mjetet. Parimisht mjetet nga ish-ndërmarrjet publike do të përdoren vetëm për investime kapitale në infrastrukturë apo kapital njerëzor, duke e ndjekur logjikën e shkëmbimit “aset për aset”. Projektet e mundshme janë projektet prioritare si Kosova e Re, projektet rrugore apo rivitalizimi i Trepçës. Një pjesë e fondeve mund të drejtohen edhe drejt projekteve investuese në kapitalin njerëzor të parapara në SKZH.*
- 2) *Miratimi i ndryshimeve legjislativë që do të mundësonin zhbllokimin e fondit dhe krijimin e mekanizmave për shpenzimin e mjeteve (përmes buxhetit, ose përmes mekanizmave të financimit special). Ky proces do të përfshijë ndryshimin e Ligjit të AKP-së dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësiive. Kalimi i mjeteve në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës (me garanci ligjore për përdorimin e tyre vetëm për destinacionet e parapara) ose në mekanizmin e financimit special.*
- 3) *Zbatimi i projekteve dhe nismave konkrete duke i përdorur mjetet nga Fondi i Privatizimit nëpërmjet: a) alokimeve buxhetore apo b) mekanizmave speciale të themeluara, si për shembull Këshilli Kombëtar për Investime.*
- 4) *Sigurimi i mbrojtjes së të drejtave përkatëse pronësore të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, si dhe garantimi dhe fuqizimi i të drejtave pronësore për gratë.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Përdorimi i mjeteve nga fondi i privatizimit do të krijojë hapësirë fiskale për investime kapitale e për rrjedhojë do të mundësojë që rritja ekonomike të jetë më pak e varur nga borxhet. Përdorimi i këtyre mjeteve po ashtu do të ndihmojë në ruajtjen e bazave të forta makroekonomike. Ndikimi më i veçantë i kësaj mase do të përcaktohet dhe dihet në momentin kur të merren vendimet për sektorët apo nismat konkrete në të cilat do të mund të investohen mjetet – pra nëse ndikimi do të jetë në sektorin e energjisë, atë të minierave, të arsimit, etj.

QEVERISJE E MIRË DHE PERFORMANCË E KËNAQSHME E KORPORATAVE ME AKSIONE SHETËRORE

CILA ËSHTË SFIDA? Qeverisja e mirë e ndërmarrjeve publike është shumë e rëndësishme në tregje efikase dhe të hapura ku ndërmarrjet publike garojnë me sektorin privat, si në nivelin e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Menaxhimi i efikas i ndërmarrjeve publike ka pasur ndikim në jetën e qytetarëve dhe në konkurrueshmërinë e ekonomisë, teksa ato e përbëjnë boshtin e infrastrukturës dhe ofrojnë shërbime të përdorura prej të gjitha industrive (p.sh. telekomunikacioni apo energjia).

CILAT JANË SHKAQET? Ekziston vlerësimi se ndërmarrjet publike kanë operuar deri më tani në mënyrë joefikase, pa mekanizma të mirëfilltë të llogaridhënies ndaj aksionarit kryesor (shtetit), dhe kështu e kanë humbur vlerën. Për më tepër, parimet themelore të qeverisjes korporative, siç janë monitorimi, auditimi financiar dhe i performancës si dhe transparenca e përgjithshme janë në masë të madhe të neglizhuara. Gjithashtu, konsiderohet se mungesa e një procesi të mirëfilltë të analizës së rrezikut nga ndërmarrjet shtetërore në buxhet dhe në ekonominë e shtetit, rezulton me vlerësim të dobët të zhvillimit të ndërmarrjeve.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH do të përmirësojë efikasitetin e ndërmarrjeve publike në përputhje me parimet e qeverisjes korporative të OECD-së. Në këtë kuadër, qeveria do t'i shqyrtojë opsionet për qasje sektoriale në mbikëqyrjen dhe menaxhimin e korporatave në pronësi publike. Një intervenim me rëndësi për përmirësimin e qeverisjes korporative përfshin trajnimin e zyrtarëve në sektorët/dikasteret përkatës.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Shqyrtimi i opsioneve për qasje sektoriale në mbikëqyrjen dhe menaxhimin e korporatave në pronësi publike nga pronari.*
- 2) *Zhvillimi i proceseve dhe analizave të rrezikut nga ndërmarrjet shtetërore në buxhet dhe në ekonominë e shtetit. Deri në vitin 2021 të gjitha ndërmarrjet shtetërore vlerësohen me opinion të pavarur nga auditori i jashtëm.*
- 3) *Trajnimi i zyrtarëve në sektorët dikasteret përkatës në qeverisje korporative. Deri në vitin 2021 të gjithë anëtarët e bordeve të korporatave do të jenë të trajnuar në qeverisje korporative.*
- 4) *Futja e sistemit MBO (menaxhmenti sipas objektivave) në vlerësimet e performancës së organeve qeverisëse të ndërmarrjeve publike*
- 5) *Shqyrtimi i mundësive për eliminimin e burokracisë dhe ndikimit në ndërmarrjet komerciale që operojnë në tregje konkurruese.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i kësaj mase do të çojë deri te përmirësimi i performancës së ndërmarrjeve me asete në pronësi shtetërore, rrjedhimisht deri te rritja e kontributit të tyre në rritjen ekonomike, rritja e vlerës së ndërmarrjeve dhe rritja e të ardhurave për buxhetin e shtetit përmes dividendit.



INFRASTRUKTURA

Pse infrastruktura?

Aktivitetet ekonomike nuk mund të analizohen dhe zhvillohen pa kontekstin rrethues. Bizneset dhe qytetarët kanë nevojë për infrastrukturë dhe mjedis të përshtatshëm për të investuar dhe punuar. Një fabrike i duhet furnizim sa më i lirë dhe sa më i qëndrueshëm me energji dhe ujë, si dhe mënyra sa më të lira dhe më të shpejta për t'i transportuar mallrat në treg. Bizneseve bashkëkohore pa dyshim se u duhet edhe infrastruktura teknologjike për t'ua rritur produktivitetin dhe ulur kostot operative. Bujqësisë i duhet infrastruktura përcjellëse si ajo e ujitjes. Por të gjithave u duhet edhe një mjedis dhe ekosistem i qëndrueshëm, sepse natyra është infrastruktura kryesore e jetës. Prandaj, shfrytëzimi i burimeve natyrore duhet të jetë sa më racional, duke arritur balancë mes nevojave të menjëhershme ekonomike dhe qëndrueshmërisë mjedisore.

Ndërhyrjet e SKZH?

- **Rritja e kapacitetit vendor të prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti dhe burimet e ripërtëritshme.** Kjo do të mundësojë furnizim të qëndrueshëm me energji për qytetarët dhe bizneset, krijimin e një klime të përshtatshme për investime dhe uljen e deficitit tregtar. Do të thotë se një biznes nuk do ta ketë më shqetësim furnizimin me energji elektrike për të investuar në Kosovë.

- **Ndërtimi i linjës së transmisionit me Shqipërinë për të mundësuar optimizimin e sistemit.** Kjo do të mundësojë furnizim më të qëndrueshëm dhe më të lirë me energji, sidomos në kohët e pikut të konsumit. Kjo do të thotë se Kosova nuk do të mbesë pa energji elektrike në dimër, nuk do të importojë energji me çmim të shtrenjtë, si dhe shpenzimet e qytetarëve dhe bizneseve do të jenë më të vogla.

- **Investimi në masa të efijencës për konsumin e energjisë.** Kjo do të ulë konsumin e brendshëm të energjisë e me këtë edhe shpenzimet financiare, duke mundësuar rritje të investimeve dhe ndikim më të pakët në mjedis. Do të thotë se një biznes do të paguajë më pak për rrymë për shkak të investimeve izoluese në mjediset industriale.

- **Përfundimi i akteve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale rrugore si dhe linja ndërkombëtare hekurudhore.** Kjo do të mundësojë qarkullim më të shpejtë dhe më të lirë të qytetarëve dhe mallrave, duke ulur kostot e biznesit. Do të thotë se një biznes do ta ketë më të lehtë për t'i plasuar mallrat në tregjet lokale e ndërkombëtare.

- **Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike.** Kjo do të bëjë që të ulen kostot operacionale të cilat do të mundësojnë rritje të investimeve si dhe rritje të inovacionit. Do të thotë se një biznes do të kursejë nga përdorimi i teknologjisë dhe mund t'i përdorë kursimet për të investuar në linjë të re biznesi.

- **Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore.** Kjo do ndihmojë në uljen e kostos së produkteve bujqësore, rritjen e produktivitetit dhe të ardhurave për fermerët, si dhe lehtësimin e punës së industrisë agro-përpunuese.

- **Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse.** Kjo do të bëjë që rritja e industrive të Kosovës dhe e kërkesës për ujë të shkojë paralelisht me rritjen e resurseve ujore në dispozicion. Do të thotë se bizneset dhe qytetarët do të kenë furnizim të rregullt me ujë.

- **Sigurimi i përdorimit të qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës.** Kjo do të bëjë që pyjet e Kosovës të mos degradohen dhe të shkaktohen pasoja në ekosistem, dhe që industria në Kosovë të ketë furnizim të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm.

- **Menaxhimi më i qëndrueshëm i mbeturinave.** Kjo do të bëjë që mbetjet prej konsumit të mos e dëmtojnë mjedisin dhe të rikthen për prodhim industrial, duke gjeneruar ndërkohë punësim dhe ulje të kostove për industrinë prodhuese.

NDËRTIMI I KAPACITETEVE TË REJA ENERGJETIKE DHE ENERGJIA E QËNDRUESHME

CILA ËSHTË SFIDA? Furnizimi me energji është i paqëndrueshëm dhe i kushtueshëm. Varësia e eksportit është 12% përkundër rezervave tona të mëdha të linjitet, rreth 12 miliardë ton, të cilat mund të vihen në funksion të prodhimit të energjisë në vend. Studimet për diagnostifikimin e rritjes ekonomike kanë identifikuar furnizimin me energji elektrike si një prej pengesave më të mëdha për bizneset në Kosovë, e për rrjedhojë edhe për rritje ekonomike. Rreth 50% të bizneseve në Kosovë e konsiderojnë atë si pengesë të madhe.

CILAT JANË SHKAQET? Termocentralet Kosova A dhe B kanë një kapacitet të përbashkët të instaluar prej vetëm 1478 MËË, mirëpo për shkak të vjetërsisë së tyre, aktualisht kapaciteti operativ i tyre sillet prej 915 MËË. Kapacitetet aktuale prodhuese janë të vjetruara, kanë nevojë për riparime të vazhdueshme dhe operojnë me teknologji joefikase. Qeveria e Kosovës ka një marrëveshje për dekomisionimin e Kosovës A në vitin 2017, megjithatë krahas procesit të ndërtimit të kapaciteteve të reja si dhe rekomandimeve që do të dalin nga një studim përkatës për këto çështje do të merret edhe vendimi përfundimtar. Kosova ka pasuri të madhe të burimeve të linjitet, rreth 12 miliard ton, për të cilat nevojitet investimi në kapacitete të reja gjeneruese. Por ndërkohë, derisa kapacitetet e reja të ndërtohen, duhet të përmbushet nevoja për energji. Kërkesa për energji elektrike ka një trajektore në rritje që është e ndërlidhur me rritjen ekonomike. Parashikimet e Bankës Botërore theksojnë një rritje të dukshme të kërkesës për energji elektrike, të cilat gjithashtu paraqiten edhe “skenarë të ulët”.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH synon të adresojë problemet në lidhje me furnizimin e qëndrueshëm të energjisë elektrike. Përmes një sërë aktiviteteve, kapacitetet e prodhimit të energjisë elektrike do të plotësojnë kërkesat e tregut, nuk do të kishte mungesë të furnizimit me energji elektrike dhe do të adresohen standardet mjedisore.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) Zgjatja e procesit të dekomisionimit të TC Kosova A deri në futjen në operim të TC Kosova e Re dhe analizimi i varianteve për operimin e TC Kosova A në periudha të ndryshme,
- 2) Rehabilitimi i TC Kosova B për secilën njësi ndaras gjatë periudhës 2017-2018, në mënyrë që të mënjanohej mungesa të mëdha të prodhimit të energjisë.
- 3) Ndërtimi i Termocentrali Kosova e Re me kapacitet gjenerimi prej 500 MËË, sipas marrëveshjes me konsorciumin ndërkombëtar, dhe në përputhje me teknologjitë më të reja.
- 4) Zbatimi i reformave strukturore në KEK, si për shembull ndarja ligjore e aktivitetit të gjenerimit nga minierat;
- 5) Hapja e minierës së re të thëngjillit (Sibofci Jugor) me qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit me thëngjill të kapaciteteve prodhuese.

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Sigurimi i energjisë së qëndrueshme do të ndikojë në përmirësimin e kushteve të të bërit biznes, do të mundësojë rritjen e investimeve private dhe do të përmirësojë bilancin tregtar të Kosovës duke i ulur importet. Furnizimi i qëndrueshëm do të përmirësojë edhe mirëqenien e qytetarëve. Rritja e investimeve do të mundësojë norma më të larta të rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

KRIJIMI I NJË TREGU TË HAPUR DHE KONKURUES TË ENERGISË ELEKTRIKE

CILA ËSHTË SFIDA? Kosova përballet me çmime të larta të importit të energjisë. Kostoja e lartë e importit të energjisë është shumë problematike dhe ndikon në rritjen e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët dhe bizneset. Ajo bëhet problem sidomos gjatë kohës së pikut të konsumit kur prodhimi i brendshëm nuk është i mjaftueshëm për ta përballuar kërkesën. Kërkesa për energji elektrike në Kosovë është e pabalancuar në aspektin sezonal, me rritje të konsiderueshme të konsumit të energjisë elektrike sidomos gjatë muajve të dimrit, kryesisht për shkak të përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje. Pikërisht gjatë pikut janë më të larta edhe çmimet e importit.

CILAT JANË SHKAQET? Importi aktualisht është i shtrenjtë për shkak të mungesës së diversitetit në qasje në sistemet rajonale të transmisionit. Veçanërisht është problematike mungesa e lidhjes me Shqipërinë, e cila prodhon 98% të energjisë përmes hidrocentraleve, me nivel më të lartë prodhimi pikërisht gjatë dimrit. Lidhja me Shqipërinë është kyç për hapjen e tregut dhe uljen e çmimeve të importit të energjisë elektrike.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH synon që të vazhdohet me zbatimin e Direktivave të BE-së (Pakoja e Tretë e Energjisë) për të krijuar një treg konkurrues, si dhe vazhdimin e zbatimit të projektit për fuqizimin e rrjetit të transmisionit të energjisë elektrike me Shqipërinë.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Integrimi i tregut të energjisë me tregun rajonal të energjisë, në përputhje me zotimet e procesit të Berlinit dhe me Direktivat e BE-së (Pakoja e Tretë e Energjisë).*
- 2) *Funksionalizimi i linjës së transmisionit me Shqipërinë në nivelin e tensionit të lartë me kapacitet prej 400 KV, në mënyrë që të ndërtohet tregu i përbashkët në sektorin e energjisë mes Kosovës dhe Shqipërisë.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Integrim në tregun rajonal të energjisë do të diversifikojë burimet e importeve dhe do të ulë kostot në kohët e pikut të konsumit. Ulja e kostos së importit do të reflektojë pozitivisht në koston e energjisë për bizneset dhe konsumatorët. Krijimi i një tregu të qëndrueshëm dhe të përballeshëm për furnizim me energji elektrike do të krijojë kushte për efikasitet më të lartë të operimit të tregut të përbashkët me energji në përputhje me kërkesat e BE-së dhe klimë të favorshme për investime, gjë që do të mundësojë normë më të lartë të rritjes ekonomike.

ULJA E KONSUMIT TË ENERGJISË PËRMES MASAVE TË EFIÇENCËS

CILA ËSHTË SFIDA? Shprehitë e konsumimit si dhe teknologjitë ekzistuese të përdorura nga konsumatorët, duke përfshirë këtu edhe izolimin e objekteve, bëjnë që energjia në Kosovë të konsumohet në mënyrë joeficiente. Konsumimi joeficient i energjisë e rritë kërkesën për energji, gjë që po ashtu ndikon shumë në koston e energjisë, duke e marrë parasysh nevojën për import. Kësisoj konsumi joeficient i energjisë ndikon në mënyrë të tërthortë në rritjen e kostos së të bërit biznes, por edhe shkakton pasoja mjedisore, duke e bërë zhvillimin të paqëndrueshëm.

CILAT JANË SHKAQET? Qeveria e Kosovës ka miratuar Ligjin për Efiçencën e Energjisë dhe gjithashtu ka një plan të veprimit për rritjen e efiçencës për periudhën 2011-2018. Synimi është që të arrihet objektivi i kursimeve prej 9% deri në vitin 2018. Megjithatë, masat që janë marrë deri tani kanë qenë kryesisht të kufizuara te ndërtesat e sektorit publik, ndërkohë që konsumatorët më të mëdhenj të energjisë në Kosovë janë familjet (më shumë se një e treta e konsumit), të vijuar nga transporti dhe bujqësia.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH do të arrijë cakun prej 9% të kursimeve të energjisë deri në vitin 2018 duke u fokusuar edhe në sektorin e banimit. Për ta arritur këtë synim, qeveria do të krijojë Fondin Kombëtar për Efiçencë të Energjisë, do të nisë zhvillimin e tregjeve për ESCO (kompanive që fitojnë nga përmirësimi i shpenzimeve në energji) si dhe do të zgjerojë rrjetin e ngrohjeve urbane.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Shqyrtimi i modaliteteve dhe krijimi i Fondit për Efiçencë të Energjisë. Fondi do të sigurojë subvencione për sistemet e ngrohjes qendrore, për masat e efiçencës në lidhje me ndërtesat ose infrastrukturën publike; investime në izolimin termik të ndërtesave; dhënien e kredive dhe garancive të kredive për ekonomitë familjare dhe NVM-të për masat e efiçencës së energjisë, etj. Fondi po ashtu do t'i finalizojë projektet e parapara në Planin Kombëtar të Veprimit për Efiçencë të Energjisë.*
- 2) *Fillimi i zbatimit të praktikës së kontratave të performancës për kursimit të energjisë përmes zhvillimit të tregut të ESCO (kompani të shërbimit të energjisë). Këto kompani do të sigurojnë kursime të energjisë duke investuar në masa të efiçencës dhe duke fituar një pjesë e kursimeve të realizuara.*
- 3) *Zgjerimi i rrjetit të ngrohjeve në Prishtinë si dhe ndërrimi i lëndës djegëse që përdoret në ngrohtoren e Gjakovës, Mitrovicës dhe Zveçanit. Gjithashtu, do të bëhet shtrirja e rrjetit të ngrohjes edhe në qytetin e Obiliqit dhe Drenasit.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i këtyre masave do të ulë konsumin e brendshëm të energjisë, me ç'rast shfrytëzimi i energjisë për kokë banori ulet për 25% deri në vitin 2022. Shfrytëzimi racional i energjisë do të ndihmojë në uljen e koston së energjisë e për rrjedhojë do të ndihmojë bizneset dhe do të rrisë investimet e sektorit privat. Rritja e investimeve do të mundësojë norma më të larta të rritjes ekonomike dhe zhvillimit.

SHFRYTËZIMI RACIONAL I BURIMEVE TË RIPËRTRTSHME TË ENERGJISË

CILA ËSHTË SFIDA? Kosova aktualisht nuk i shfrytëzon aq sa duhet burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE). Ajo prodhon vetëm 3% të energjisë elektrike, apo 48.18 MW, mirëpo nëse themi të energjisë atëherë Kosova ka 18,9 % të pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme në bruto konsumin përfundimtar të energjisë. Kjo është përqindje shumë më e ulët se zotimi prej 25% të caktimit obligativ (29.5% të caktimit promovues) të konsumit deri në vitin 2020. Mospërdorimi i burimeve të energjisë së ripërtëritshme të energjisë kontribuon në nevojën për të importuar energji dhe pasigurinë e furnizimit në tregun vendas. Kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit.

CILAT JANË SHKAQET? Kosova ka potencial të vogël për prodhimin e energjisë nga era, e fare pak potencial për prodhim nga dielli. Burime më të qëndrueshme të energjisë së ripërtëritshme janë kryesisht energjia hidrike dhe biomasa dhe biogasi. Janë rreth 77 vende ku mund të zhvillohen hidrocentrale të vogla me kapacitet të instaluar prej 128 MËË. Vlerësimi është se rreth 120 GWh energji në vit mund të prodhohen nga biomasa (mbetjet e pyjeve). Megjithatë, zhvillimi i projekteve të kësaj natyre ka ngecur, në masë të madhe për shkak të kostos. Hidrocentrali i Zhurit, më i madhi nga projektet hidro, ka mbetur në fazën e studimit të fizibilitetit. Në anën tjetër, mbetjet e bagëtive që shërbejnë për prodhim të biogazit, janë të shtrira gjithandej nëpër vend dhe është e kushtueshme të mbledhen në një hapësirë të centralizuar.

CILAT JANË ZGJIDHJET? Meqë potenciali për shfrytëzimin e BRE-së është relativisht i kufizuar në Kosovë, qeveria duhet të negociojë një synim më të ulët për shfrytëzimin e BRE për shkak të kostove. Tani më ZRR ka aprovuar tarifën nxitëse ('Feed-in Tariff') për të gjitha llojet e burimeve të ripërtitshme dhe kriteret e nevojshme për të marrë certifikatën e origjinës, gjë që paraqet hap lehtësues për nxitjen e investimeve për investitorët për prodhimin e energjisë nga BRE. Do të lëvizet përpara me shqyrtimin e mundësive për ndërtimin e hidrocentralit të Zhurit si dhe me ofrimin e mbështetjes për fermerë përmes kontratave për shfrytëzimin e mbeturinave organike dhe organizimin më të mirë të tregut të drurit dhe mbetjeve malore.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Rishikimi dhe negociimi i çaqeve më të ulëta për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në harmoni me kërkesat e Komunitetit të Energjisë.*
- 2) *Analiza e studimit të fizibilitetit të Hidrocentralit të Zhurit në kontekst të zhvillimit të tregut të përbashkët me Shqipërinë. Ndërtimi i tij potencial do të bëhet qoftë përmes investitorit privat, ndonjë forme të partneritetit publik-privat (PPP), ose eventualisht si projekt shtetëror me mundësi kontrate koncesioni.*
- 3) *Mundësimi i kontratave afatgjata për fermerë që të shfrytëzohen mbetjet organike si dhe sigurimi i organizimit më të mirë të tregut të drurit dhe mbetjeve malore, në mënyrë që të stimulohet krijimi i tregut të biomasës. E gjithë kjo shkon përkrah rregullimit të tarifave nxitëse të tregut të biomasës.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i këtyre masave do të rrisë përfshirjen e burimeve të ripërtëritshme të energjisë brenda energjisë së prodhuar në vend. Me këtë Kosova do të afrohej në përmbytjen e zotimeve të saja ndërkombëtare si dhe do të rriste sasinë e energjisë së prodhuar në vend, duke kontribuar kështu në sigurinë energjetike në vend, e me këtë në përmirësimin e klimës së të bërit biznes, në rritjen e investimeve dhe rritjen ekonomike. Përdorimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë po ashtu do të siguronte që rritja ekonomike e vendit të jetë më e qëndrueshme dhe më e vëmendshme ndaj pasojave në natyrë.

ZHVILLIMI I MËTEJME I INFRASTRUKTURËS RRUGORE DHE HEKURUDHORE

CILA ËSHTË SFIDA? Infrastruktura e transportit luan rol kyç për zhvillimin ekonomik, përdërisa e lehtëson qarkullimin e njerëzve dhe mallrave duke e rritur shpejtësinë dhe ulur koston. Infrastruktura e transportit është veçanërisht e rëndësishme për transportin ndërkombëtar, ndërkohë që synimi i ekonomisë sonë është që të nxisë eksportet. Gjatë viteve të fundit është investuar shumë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore strategjike dhe rrugëve rajonale. Megjithatë, nevojat e vendit për infrastrukturë të transportit mbeten të mëdha, sidomos lidhja më e mirë dhe më e shpejtë mes rajoneve, e cila do të mundësonte mobilitet më të madh të fuqisë punëtore, mallrave dhe kapitalit. Cilësia e infrastrukturës vlerësohet si një ndër faktorët kyç në vendimin e investitorëve për të investuar në një vend.

CILAT JANË SHKAQET? Vetëm 56% të infrastrukturës rrugore të Kosovës është e shtruar me asfalt (akset kryesore nacionale), ndërsa një pjesë tjetër mbetet e pa përfshirë. Rrjeti hekurudhor në anën tjetër ka rreth 330 km, por me infrastrukturë të vjetruar. Kosova ka nivel të ulët të urbanizimit, gjë që e ul intensitetin e transportit (numrin e udhëtarëve për kokë banori). Gjeografia e Kosovës nënkupton se distancat janë të shkurtra, prandaj edhe transporti rrugor është forma më efektive dhe e qëndrueshme për qarkullim. Në mënyrë që të arrihet efekti më i madh zhvillimor në rrugët lokale, ka nevojë që investimet në rrugë të shoqërohen me studime paraprake. Në anën tjetër, rrugët rajonale duhen zgjeruar për të mundësuar qarkullim më të shpejtë. Transporti hekurudhor mund të luajë rol të rëndësishëm për eksportin e mineraleve dhe mallrave bujqësore.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKZH do të mundësojë vazhdimin e punës në ndërtimin e akteve kryesore ndërkombëtare rrugore (që na lidhin me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Serbinë), si dhe autostradave rajonale. Prioritet do t'i jepet edhe rindërtimit të linjës ndërkombëtare hekurudhore që na lidh me Serbinë dhe Maqedoninë.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) Finalizimi i segmentit të mbetur Besi – Merdare të Autostradës Morinë – Merdar (R7)
- 2) Përfundimi i ndërtimit të Autostradës Prishtinë – Han i Elezit (R6) për t'u lidhur me Korridorin e VIII të Evropës Juglindore.
- 3) Vazhdimi i projektit të zgjerimit të rrugëve nacionale Prishtinë – Pejë (M9) dhe Prishtinë – Mitrovicë (M2)
- 4) Zgjerimi i rrugës nacionale Prishtinë - Podujevë
- 5) Zgjerimi i rrugëve nacionale Pejë – Deçan – Gjakovë – Prizren.
- 6) Ndërtimi i autostradës Prishtinë – Gjiilan – Dheu i bardhë
- 7) Modernizimi i linjës së vetme ndërkombëtare hekurudhore në Kosovë, Linja 10 (148 km e gjatë) prej Fushë Kosovës në Maqedoni (linja jugore) dhe prej Fushë Kosovës në Serbi (linja veriore)

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i këtyre masave do të ulë koston dhe distancat e transportit të njerëzve dhe mallrave brenda dhe jashtë Kosovës. Mundësia për transport më të shpejtë dhe më të lirë do t'ju ndihmojë të gjitha industrive të Kosovës për t'i siguruar më lirë lëndët e para dhe për t'i plasuar më lirë prodhimet në treg. Modernizimi i rrjetit hekurudhor ndërkombëtar do të ndihmojë sektorin e eksportit të mineraleve dhe mallrave bujqësore. Përmirësimi i infrastrukturës së transportit do të nxisë edhe investime të reja. E gjithë kjo do të mundësojë norma më të larta të rritjes ekonomike.

SHTRIRJA E INFRASTRUKTURËS SË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

CILA ËSHTË SFIDA? Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) ka revolucionarizuar mënyrat se si zhvillohen proceset shoqërore, prej transaksioneve ekonomike në treg, te administrimi i shtetit e deri te të nxënit në shkollë. Në Kosovë, përdorimi i kompjuterëve dhe internetit nëpër shtëpi private ka shënuar rritje të konsiderueshme. Sidoqoftë, përdorimi i TIK vazhdon të mbetet i kufizuar në institucionet publike apo edhe në kompanitë private. Kjo e kufizon cilësinë e shërbimeve të shtetit dhe efikasitetin e institucioneve, ndërkohë që praktikrat e vjetra administrative po ashtu kanë kosto më të lartë, duke bërë që mjetet buxhetore të mos harxhohen në fusha të tjera ku ka më shumë nevojë. Bizneset në anën tjetër harxhojnë më shumë se sa që duhet duke mos përfshirë mjete të TIK në operimet e tyre.

CILAT JANË SHKAQET? Shkollat rurale, bibliotekat, institucionet shëndetësore dhe agjencitë qeveritare vuajnë ose nga mungesa e qasjes në shërbimet e TI-ut, ose nuk i kanë adoptuar mjetet e duhura. Nuk ekziston ndonjë institucion i nivelit qendror për koordinim dhe zhvillim të bilancit të nën-sektorëve të ndryshëm të TI-ut, ose i cili do t'i promovonte standardet ndërkombëtare. Nuk janë dhënë stimuj për sektorin privat që të investojë në proceset e TI.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKHZ do të sigurojë koordinimin e aktorëve të ndryshëm të sektorit të TIK në mënyrë që të sigurohet shtrirja dhe përdorimi sa më i gjerë i teknologjisë informative në proceset e bizneseve, institucioneve publike dhe institucioneve arsimore.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Krijimi i Këshillit Nacional për TI i cili do t'i koordinojë aspektet e ndryshme të strategjisë së zhvillimit dhe zbatimit të TI.*
- 2) *Mbështetja e bizneseve kosovare të fushës së TI (përmes Fondit për Punësim dhe Zhvillim) për të eksportuar shërbime jashtë vendit si dhe biznese të tjera për të përparuar proceset e punës nëpërmjet përdorimit të TI (Shiko masën 20, aktiviteti 4).*
- 3) *Miratimi i standardeve ndërkombëtare përkatëse të TIK-ut për institucionet publike dhe bizneset.*
- 4) *Zbatimi i Programit për Ekonominë Digjitale të Kosovës – KODE (përmes skemës për TIK në Fondin për Punësimi dhe Zhvillim) i cili do të përfshirje shtrirjen e infrastrukturës me brez të gjerë dhe me shpejtësi të lartë si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore për ekonominë digjitale.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Përdorimi më i shpeshtë i TIK-ut në proceset administrative, arsimore, tregtare, etj – do të ndihmojë në uljen e kostove operacionale dhe krijimin e efijencës, e për rrjedhojë do t'i mundësojë shtetit dhe kompanive private që kursimet t'i orientojnë në investime në fusha të tjera. Përdorimi i TIK-ut po ashtu do të mundësojë inovacion në proceset operative të sektorit privat dhe forcimin e këtij të fundit. Rritja e mundësive për investime dhe inovacion do të mundësojë normë më të lartë të rritjes ekonomike.

INFRASTRUKTURA BUJQËSORE NË FUNKSION TË AGRO-BIZNESIT

CILA ËSHTË SFIDA? Sektori i bujqësisë në Kosovë është një ndër sektorët me mundësitë më të mëdha për punësim, por edhe është shumë i rëndësishëm për industrinë e tjera të ndërlidhura në zinxhirin e vlerës përderisa prodhimet bujqësore përdoren prej industrisë agro-përpunuese. Rritja e prodhimit bujqësor dhe e industrisë agro-përpunuese është shumë e rëndësishme marrë parasysh edhe nevojën për uljen e deficitit tregtar. Por forcimi i këtij sektori sot është problematik jo vetëm për shkak të parcializimit të tokave (të adresuar në Shtyllën 2 të SKZH), por edhe infrastrukturën e kufizuar bujqësore

CILAT JANË SHKAQET? Rritja e kapaciteteve prodhuese në bujqësi dhe industrinë agro-përpunuese sot kufizohet kryesisht nga mungesat në infrastrukturën fizike mbështetëse. Shkalla aktuale prej 25% e ujitjes së tokës së punueshme ka nevojë për t'u zgjeruar. Kjo posaçërisht është e lidhur me potencialin e Kosovës për të nxjerrë të ardhura nga sektori i frutave me vlerë të lartë dhe perimeve. Në anën tjetër, zhvillimi më i hovshëm i sektorit të bujqësisë dhe industrisë agro-përpunuese vuan edhe nga numri i kufizuar i objekteve të deponimit dhe magazinimit në rajonet kryesore të Kosovës, si dhe i njësisve për testimin laboratorik të cilësisë së prodhimit privat të farërave dhe standardeve sanitare.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKHZ do të sigurojë adresimin e sfidave sa i përket infrastrukturës fizike, duke e përfshirë infrastrukturën e butë dhe atë fizike. Kjo do të përfshijë zgjerimin e mbulueshmërisë së sistemeve të ujitjes në rajonet e Kosovës me potencial të lartë për prodhim; përmirësimin e tregut të shitjes me shumicë, uljen e kostove të transaksionit si dhe përmirësimin e ekonomive të shkallës dhe reduktimin e mbetjeve në sezonin e vjeljeve.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku në 40% të tokës së punueshme deri në vitin 2021 (nga ajo aktuale prej 25%)
- 2) Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit në rajonet kryesore të Kosovës përmes Partneriteteve Publiko-Private (PPP).
- 3) Rritja e numrit të njësisve të testimit laboratorik për cilësinë e prodhimit privat të farërave dhe përmirësimi i standardeve fitosanitare.
- 4) Rritja dhe përmirësimi i strukturave të fermave, si dhe rritja e kapacitetet përpunuese të industrisë ushqimore, si p.sh.: mishit, qumështit, pemëve, perimeve dhe rrushit.
- 5) Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të informatave (MIS) për regjistrin e fermave dhe lëndëve bujqësore (Shiko masën 20, aktiviteti 3).

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i këtyre masave do të ndikojë në përmirësimin e produktivitetit bujqësor; përmirësimin e ekonomive të shkallës në prodhim bujqësor nëpërmjet infrastrukturës së tregut të shitjes me shumicë si dhe në përmirësimin e konsolidimit të tokës nëpërmjet një sistemi më funksional të regjistrimit të fermave. Rritja e produktivitetit bujqësor, ekonomisë së shkallës dhe inovacionit do të përkthehet në ulje të kostove për industrinë agro-përpunuese dhe rritjen e saj, si dhe do të ndihmojë në sigurimin e normave më të larta të rritjes ekonomike.

SHFRYTËZIMI RACIONAL DHE RITJA E KAPACITETIT TË BURIMEVE UJORE

CILA ËSHTË SFIDA? Rezervat ujore të një shteti dhe infrastruktura e ujësjellësve luajnë rol tepër të rëndësishëm për cilësinë e jetës dhe zhvillimin ekonomik. Me nivelin aktual të kërkesës për ujë, Kosova për momentin i ka arritur kufijtë e kapaciteteve ekzistuese të rezervuarëve dhe infrastrukturës shpërndarëse, ndonëse burimet dhe rezervat janë të shumta. Duke e marrë parasysh faktin se Kosova synon të ketë rritje të prodhimit industrial dhe bujqësor në vitet e ardhshme, nevojiten investime për të siguruar furnizim të mjaftueshëm me ujë. Burimet e pamjaftueshme rrezikojnë të kthehen në problem serioz, si për rritjen e aktivitetit ekonomik ashtu për përdorimin shtëpiak.

CILAT JANË SHKAQET? Sfidat kryesore në sektorin e ujërave janë humbjet në rrjet, mungesa e masave të efijencës për konsumim, mungesa e kapaciteteve të deponimit të ujërave dhe sistemet relativisht të pazhvilluara dhe joefijente të ujitjes në bujqësi. Deponimi në rezervuare për kokë banori është sa 42% e mesatares rajonale. Efikasiteti i sistemeve të ujitjes është shumë i ulët, ndërsa humbjet teknike për shkak të gypave të vjetër janë gjithashtu shumë të larta. Problem mbetet edhe aftësia e kompanive rajonale të ujësjellësve për t'i mbledhur të ardhurat nga shitja (vetëm 30%), e për rrjedhojë pamundësia financiare e tyre për të investuar në përmirësimin e rrjetit apo zgjerimin e tij.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKHZ do të sigurojë që të ulët nivelin e harxhimit të ujit përmes konsumit racional dhe uljes së humbjeve teknike, si dhe do t'i japë prioritet rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të kompanive rajonale të furnizimit me ujë, si dhe vendosja e ujëmatësve në të gjitha zonat e shërbimit me ujë.*
- 2) *Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndërtimi i rrjetit të ri në zonat me shkallë të lartë të ngarkesës (zgjerimi i mbulimit urban dhe rural). Rrjeti i mbulimit do të rritet nga 12.000 hektarë në 29.000 hektarë.*
- 3) *Realizimi i studimit të fizibilitetit për lokacionet e mundshme për ndërtimin e akumulimit të ujërave sipërfaqësore (digat).*
- 4) *Dizajnimi i projektit për ndërtimin e Hidrosistemit "Ibër-Lepenc" (faza II) dhe Hidrosistemi Kremenat-Desivojcë-Gjyrishevc.*
- 5) *Investimi në zgjerim dhe rritje të efijencës të sistemeve të ujitjes bujqësore.*
- 6) *Renovimi dhe ndërtimi i infrastrukturës mbrojtëse përgjatë lumenjve të Sitnicës, Drinit të bardhë dhe Moravës së Binçës.*
- 7) *Renovimi dhe zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm për rajonin e Prishtinës, Gjilanit dhe Mitrovicës*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Përmes zbatimit të kësaj mase do të rritet shkalla e efijencës në përdorimin e ujit dhe do të rritet shkalla e kontrollit dhe raportimit mbi sasinë e ujit të shfrytëzuar / konsumuar. Në veçanti do të mundësohet rritja e të ardhurave për kompanitë e ujësjellësve, ulja e nivelit të humbjeve, rritja e normës së kyçjeve në rrjet dhe zgjerimi i mbulimit nga rrjeti i ujitjes. Përmirësimi i furnizimit me ujë do të shërbejë si mbështetës për rritjen e ndërmarrjeve dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

SHFRYTËZIMI DHE MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I PYJEVE

CILA ËSHTË SFIDA? Rëndësia strategjike e pyjeve për një vend të vogël e të populluar dendur si Kosova, me dimër të ftohtë dhe një sektor të konsiderueshëm të përpunimit të drurit, vështirë se mund të nënvlerësohet. Sistemet e mira të menaxhimit të pyjeve janë të domosdoshme për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me material drusor që përdoret për ngrohje apo qëllime industriale. Shpyllëzimi që po ndodh tani e vështirëson këtë furnizim të qëndrueshëm por edhe pengon ekosistemin dhe kafshët e egra, rezulton me erozion të tokës dhe rrit gjasat e përmytjeve, pasi pemët thithin ujë. Shpyllëzimi mund të kenë ndikim të madh ekonomik dhe social në zonat përreth pyjeve, veçanërisht tokat bujqësore. Ky rrezik është edhe më i rritur më tej në një kohë kur tokat bujqësore do të jetë nën kërcënim nga cikle ekstreme të motit për shkak të ndryshimit të klimës.

CILAT JANË SHKAQET? Kërkesa e lartë për dru, e shkaktuar nga përdorimi i tyre për ngrohje dhe përpunim të mëtejshëm në industri, është duke vënë shumë presion mbi rezervën ekzistuese të tokave pyjore. Normat e prerjeve (legale dhe ilegale) janë dukshëm më të larta se norma e rigjenerimit të pyjeve. Në Kosovë fatkeqësisht rreth 40% të pyjeve publike dhe 30% të pyjeve private përballen me prerje ilegale. Problem i madh përbën edhe menaxhimi i pyjeve, teksa një hapësirë e kufizuar pyjore ka plane për menaxhimin e pyjeve. Problemi kryesor, megjithatë, është kapaciteti i institucioneve për të menaxhuar dhe parandaluar abuzimet me pyjet.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKHZ do të sigurojë që të ndalet rritimi i shpyllëzimit të pyjeve të Kosovës dhe të fillojë rigjenerimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i tyre, në funksion të konsumatorëve dhe përdorimit në sektorët industrial.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) *Pyllëzimit i sipërfaqeve të zhveshura pyjore, rimëkëmbja e pyjeve të dëmtuara nga zjarri dhe ndërmarrja e masave parandaluese të dëmtimit përmes trajtimit me preparate entomologjike. Të gjitha këto do të realizohen përmes një programi kombëtar dhe të planifikuar mirë për mbrojtjen e pyjeve.*
- 2) *Ndërmarrja e masave më të ashpra kundër prerësve ilegalë, gjë që nënkupton organizim më të mirë institucional, ndryshime ligjore dhe forcim të kapaciteteve të Agjencisë Kosovare të Pyjeve. Gjithashtu, do të funksionalizohet sistemi informativ pyjor për mbrojtje më të integruar.*
- 3) *Zhvillimi i planeve për menaxhimin e pyjeve për të paktën 60% të hapësirës pyjore publike deri në vitin 2021.*

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Ndikimi i masës do të ketë efekt të drejtpërdrejt në rritjen e normës së rigjenerimit të pyjeve; vëllimin e shfrytëzimit, i cili nuk do të jetë më i madh se 60% të rritjes së parashikuar vjetore; reduktimi i pranisë së shfrytëzimit ilegal nga 40% në 20% të pyjeve publike dhe nga 29% në 15% të pyjeve private. Investimet dhe reformat në sektorin e pyjeve do të luajnë një funksion të rëndësishëm jo vetëm për mbrojtjen e mjedisit por edhe për mbështetjen e zhvillimit industrial. Përmirësimi i efikasitetit në menaxhimin më të mirë të pyjeve do të mbështesë industrinë e përpunimit të drurit, duke siguruar çmim të drejtë dhe furnizim të qëndrueshëm me lëndën e parë

MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I MBETURINAVE

CILA ËSHTË SFIDA? Rritja e ekonomisë dhe mirëqenies mundëson rritje të mundësive për konsum të mallrave, e për rrjedhojë edhe e shton sasinë e mbeturinave. Mbetjet nga konsumi në njërin anë shkaktojnë presion mbi mjedisin, duke e dëmtuar ekosistemin në rast se menaxhohet dobët grumbullimi dhe deponimi, por nëse riciklohen mund të jenë edhe aset për zhvillimin ekonomik, duke u përdorur si lëndë e parë nga industritë. Për momentin në Kosovë mbetjet janë bërë problem mjedisor dhe në anën tjetër nuk janë kthyer në shërbim të zhvillimit industrial përmes riciklimit.

CILAT JANË SHKAQET? Vetëm rreth 60% të mbeturinave në Kosovë grumbullohen. Përveç kësaj, nuk ka ndonjë aktivitet të organizuar për ndarjen e mbeturinave për ripërdorimin/riciklimin dhe trajtimin e tyre. Përjashtim bën sektori privat i cili e bën mbledhjen, ndarjen në lloje, trajtimin fizik dhe eksportimin e mbeturinave. Hedhja e mbeturinave kryesisht bëhet në deponitë rajonale / komunale (ekzistojnë gjithsej 8 deponi), shumica e të cilave nuk veprojnë/operojnë në pajtim me standardet mjedisore, por ndodhin edhe hedhje në vende të papërshtatshme dhe të pakontrolluara (deponi ilegale). Rreth 40% të mbeturinave të mbetura hidhen në mënyrë të paligjshme ose digjen. Një sasi shumë e vogël e mbeturinave riciklohen nga sektori i joformal. Po ashtu sfidë është edhe trajtimi i ujërave të ndotura dhe lymit i cili paraqitet si produkt pas procesit të trajtimit të ujërave të zeza.

CILAT JANË ZGJIDHJET? SKHZ do të mundësojë menaxhimin më efikas të mbeturinave në Kosovë duke investuar në infrastrukturën e menaxhimit, konsolidimin e kompanive publike për mbledhje, kontraktimin e operatorëve ekonomik për menaxhim mbeturinash), rritjen e vetëdijes dhe stimulimit të riciklimit, si dhe krijimin e rrjeteve grumbulluese për trajtimin e ujërave të zeza.

AKTIVITETET KONKRETE TË MASËS

- 1) Ndërtimi i infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave komunale, të ngurta, të ndërtimit, industriale dhe të rrezikshme dhe të lymit nga ujërat e ndotura.
- 2) Konsolidimi i kompanive publike për mbledhjen e mbeturinave si dhe kontraktimi i operatorëve ekonomikë përmes partneriteteve publiko-private për menaxhimin e mbeturinave (në fushën e deponimit, trajtimit dhe riciklimit).
- 3) Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe reduktimi gradual i sasisë së mbeturinave të prodhuara si dhe stimulimi i ripërdorimit ose riciklimit dhe përdorimi i produkteve të trajtimit të mbeturinave.
- 4) Implementimi i projekteve për zvogëlimin e rreziqeve mjedisore dhe shëndetësore nga mbeturinat (trajtimi i mbeturinave të rrezikshme, rehabilitimi i vendeve të ndotura / kontaminuara, eliminimi i deponive ilegale, etj.). Ndërtimi i qendrave për trajtimin e mbeturinave në këto komuna: Gjilan, Ferizaj, Prizren, Shtërpçë, Rahovec, Gjakovë, Shtime, Lipjan, Drenas, Suharekë, Kaçanik dhe Viti).
- 5) Riparimi dhe ndërtimi i rrjeteve grumbulluese për ujërat e ndotura (zeza) si dhe ndërtimi i fabrikave për trajtimin e ujërave të ndotura në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Mitrovicë. Paralelisht, do të trajtohet lymi-mbetja pas trajtimit të ujërave të ndotura nëpërmjet kontratave me operatorët ekonomik në bazë të Partneritetit Publik Privat (PPP).
- 6) Ndërtimi i stacionit bartës dhe qendrës për mbledhjen e mbeturinave (Klinë, Istog, Skenderaj, Novobërdë)
- 7) Përmirësimi i gjendjes teknike dhe operuese në deponinë e rajonit të Prishtinës në Mirash-Obiliq

NDIKIMI NË ZHVILLIM

Zbatimi i këtyre masave do të ndihmojë në uljen e dëmeve ndaj mjedisit, ekosistemit dhe cilësisë së jetës së qytetarëve, sidomos shëndetit. Investimi në riciklim dhe trajtim të mbetjeve do të mundësojë ripërdorimin e aseteve dhe kthimin e tyre në funksion të zhvillimit për industrinë e trajtimit të mbetjeve dhe industritë e tjera që i përdorin materialet e ricikluara si lëndë e parë. Kjo do të mundësojë që rritja ekonomike të jetë më e qëndrueshme dhe me ndikim më të vogël negativ ndaj mjedisit.

ZBATIMI I STRATEGJISË KOMBETARE PËR ZHVILLIM

Miratimi i SKZH-së padysim se shënon një hap përpara në planifikim të politikave dhe sistemit të monitorimit në Kosovë, që do të ndihmojë në përcaktimin e planifikimit afatgjatë të politikave zhvillimore të qeverisë.

Megjithatë, masat e përcaktuara nuk do të zbatohen vetëm sepse Qeveria i ka përfshirë ato në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH). Për t'i kthyer këto masa në rezultate konkrete, së pari duhet t'i kthejmë ato në **tregues të matshëm, me burime të mjaftueshme dhe menaxhim të përshtatshëm**. Planifikimi, buxheti, rekrutimi, komunikimi si dhe monitorimi e vlerësimi i prioritetëve të larta të shtetit duhet të jenë në nivelin më të mirë të mundshëm që mund ta bëjnë institucionet tona. Madje, edhe për sa i përket administratës tonë publike, SKZH është orientues kryesor.

Zbatimi i SKZH do të jetë proces thelbësor i Sistemit të Planifikimit të Integruar në Kosovë dhe do të përkushtohet në parimet e mëposhtme:

- **Masat e përfshira në SKZH do të kenë prioritet gjatë alokimit të burimeve derisa të financohen plotësisht e po ashtu edhe do të monitorohen nga afër, duke përfshirë kështu edhe vëmendjen e drejtpërdrejtë të Kryeministrit.** Pjesa tjetër e prioritetëve duhet të adresohen në strategjitë sektoriale dhe dokumente të tjera planifikuese. Strategjitë sektoriale dhe dokumentet tjera planifikuese duhet t'u japin prioritet masave të SKZH-së, duke i renditur prioritetet tjera sektoriale në një rang më të ulët prioritar.
- **Masat e SKZH-së do të kenë mbulueshmëri të plotë financiar, me qasje preferenciale në çdo burim shtesë nga buxheti shtetëror dhe/ose partnerët zhvillimorë.** Për më tepër këto masa do të reflektohen në Deklaratën e Prioritetëve Afatmesme të Qeverisë e cila i paraprinë Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe përfundimisht alokimeve vjetore buxhetore, e po ashtu edhe në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë.
- **Zbatimi i SKZH-së, sjell një avancim në sistemin e monitorimit qeveritar duke kaluar në matjen e rezultateve dhe performancës.** Ministrat dhe institucionet përgjegjëse për prioritetet e SKZH-së, do të hartojnë udhërrëfyes të qartë për arritjen e objektivave të SKZH-së. Këto dokumente duhet të trajtohen si një zotim publik ndaj qytetarëve të Kosovës dhe të prezantohen tek partnerët zhvillimorë. Kërkesat e monitorimit të SKZH-së do të përqendrohen në caqe dhe tregues të një niveli më të lartë. Ndërveprimi me ministritë, pra, do të ndryshojë nga ai që thekson respektimin e afateve në atë i cili mat përparimin karshi performancës dhe të objektivave të politikave afatmesme dhe afatgjata.

1) Planifikimi i veprimeve

Për t'i arritur objektivat e SKZH-së, institucionet të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e masave, duhet të planifikojnë punën e tyre në mënyrë të detajuar: kush do të bëjë çka, çfarë dhe deri kur, e po ashtu edhe sa do të kushtojë. Brenda tre muajve pas miratimit të SKZH-së, bartësit për realizimin e objektivave të saj duhet të prezantojnë dhe të diskutojnë me Zyrën për Planifikim Strategjik (ZPS) të Kryeministrit, **Udhërrëfyesin i cili detajon hapat e synuar për zbatimin e çdo mase dhe mbulon periudhën së paku katër vjeçare duke paraqitur në mënyrë specifike:**

- Shpjegim përmbledhës të problemeve të adresuara dhe logjikën për çdo intervenim;
- Caqet e pritura të përmbushjes së masave dhe progresi i pritur vjetor për arritjen e tyre;
- Veprimet kryesore të zbatimit, me rezultate dhe afat kohor për secilin veprim gjatë periudhës së planifikuar;
- Institucionet përgjegjëse dhe/ose mbështetëse në secilin prej veprimeve të përshkruara;
- Burimet e nevojshme për secilin veprim, duke përfshirë buxhetin dhe ndihmën e jashtme.

Çdo udhërrëfyes duhet të ofrojë informata të mjaftueshme për mënyrën se si institucionet përgjegjëse do ta informojnë publikun për progresin në përmbushjen e objektivave të SKZH-së. Duhet të identifikohen së paku dy organizata jo-qeveritare që konsiderohen si përfaqësuese të interesave të komunitetit, e të cilat do të përfshihen nga ministri përkatës në dialogun që do të zhvillohet gjatë zbatimit si dhe në çfarëdo ndryshimi të madh që do të bëhet në vet udhërrëfyesin. ZPS siguron udhëzimet për përpilim dhe menaxhim të udhërrëfyesve. Këto dokumente do të përdoren për të mbështetur proceset e përgatitjes së planeve vjetore të punës.

2) Lidhja me kornizat tjera të planifikimit strategjik

Edhe pse fokusi kryesor i saj do të jetë në rritje ekonomike, zbatimi i SKZH do të jetë një mjet për shtyrjen përpara të agjendës së Kosovës për integritet evropian. Në këtë aspekt, vëmendje maksimale do t'i kushtohet **harmonizimit të veprimeve për zbatimin e SKZH-së me Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së** dhe nevojën për adoptimin e mëtejshëm të acquis të BE-së. Duke marr parasysh faktin se dialogu me BE-në përfshin qasje unike dhe kërkesa të veçanta për raportim të përmbushjes së kriterëve, përpjekjet kryesore do të vendosen për të harmonizuar planifikimin e agjendës së integritet evropian dhe monitorimin me kuadrin e zbatimit të SKZH, KASH dhe PVPQ.

Përderisa SKZH-ja është më se e qartë për sa i përket prioriteteve të saj për rritje ekonomike dhe gjithëpërfshirje, Qeveria po ashtu është angazhuar në dialogun për qeverisje ekonomike me BE-në. Si pjesë e këtij dialogu, Kosova ka përgatitur **Programin e dytë për Reforma Ekonomike (PRE)**, i cili përfshinë rreth 20 prioritete të reformave strukturore të planifikuara për zbatim me qëllim që Kosova të përgatitet për t'u ballafaquar me presionet e konkurrencës në rritje, qoftë në nivel regjional dhe ndërkombëtar. Prioritetet për PRE kanë rrjedhur kryesisht nga masat e përcaktuara në kuadër të SKZH-së. Në shumë mënyra, ato përfaqësojnë elemente të SKZH-së të cilat janë thelbësore në mënyrë që Kosova të thellojë dialogun e strukturuar me BE-në si pjesë të procesit të përbashkët të qeverisjes ekonomike. Kështu, **dy dokumentet nuk janë të ndara, por plotësojnë njëra tjetrën jo vetëm sa i përket përmbajtjes por po ashtu edhe sa i përket strukturës dhe funksionit**. PRE do të azhurnohet në baza vjetore, përderisa SKZH do të jetë subjekt i vlerësimit të jashtëm çdo 2 vite, si rrjedhojë edhe përditësimit të saj.

Në këtë kontekst, Bashkimi Evropian ka iniciuar, atë që tashmë quhet si procesi i Berlinit. Në fakt ky i fundit e ka prioritetuar rëndësinë e përmirësimit të ndërlidhjes infrastrukturore të shteteve të Ballkanit Perëndimor, ndërmjet tyre dhe me BE-në. Objektivi përfundimtar i procesit të Berlinit është arritja e marrëveshjes mbi listën e investimeve kyçe infrastrukturore në Ballkanin Perëndimor dhe përmirësimi i gjendjes së përgjithshme të infrastrukturës në Ballkanin Perëndimor dhe lidhja e tyre me infrastrukturën e BE-së. Në këtë kontekst, BE-ja i ka ftuar shtetet për të themeluar Komitetet Kombëtare për Investime (KKI) dhe për të përgatitur një **Listë Prioritare të Projekteve (LPP)** të investimeve infrastrukturore. Kështu, Qeveria do të sigurojë se LPP do të shërbejë si instrument kryesor programues për koordinimin e investimeve infrastrukturore në transport, energji dhe mjedis dhe **të jetë në përputhje me SKZH**.

3) Zotimi i burimeve

Prioritetet e SKZH-së nuk mund të zbatohen pa zotimet e nevojshme financiare. Varësisht nga vlerësimet e Udhërrëfyesve nga ana e ZPS-së, Qeveria zotohet të integrojë kornizën e vet të planifikimit strategjik **për t'u siguruar që burimet financiare të kërkuara për zbatim të udhërrëfyesit** të jenë plotësisht në dispozicion brenda periudhës kohore të pritur. Në këtë mënyrë, ZPS i përfshinë veprimet e paraqitura në Udhërrëfyes si prioritetet më të larta qeveritare në Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme, të cilën e përpilon çdo vit si kontribut strategjik për KASH. Aktualisht, procesi i kostimit mund të konsiderohet si i papërfunduar, me kosto të qarta për disa masa dhe më tepër kosto indikative për tjerat - varësisht se sa është e detajuar masa.

Ministri i Financave siguron se veprimet e SKZH-së gëzojnë qasje preferenciale ndaj burimeve financiare, duke filluar prej alokimit të kufijve buxhetorë në KASH dhe pastaj në mënyrë specifike në buxhetin vjetor.

Ministri i Integrimit Evropiane siguron që masat dhe veprimet përkatëse të SKZH-së, sidomos ato të reflektuara në PRE, janë të përfshira në dialogun me komunitetin e donatorëve për programim e çdo ndihme shtesë për zhvillim. Në veçanti, MIE siguron se dokumentet planifikuese të sektorit dhe dokumentet tjera të kërkuara për programim të IPA-së II dhe fondeve tjera të BE-së janë përpiluar na bazë të prioritetëve të larta të Qeverisë, siç theksohet në SKZH dhe në Udhërrëfyesin për zbatimin e saj.

4) Fondi për Zhvillim dhe Punësim

Programi i Qeverisë së Kosovës 2015-2018 ka përcaktuar themelimin e Fondin për Zhvillim dhe Punësim, qëllimi i të cilit është përkrahja e sektorit privat që të shërbejë si mekanizëm kryesor për rritje ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës. Rrjedhimisht, Fondi do të jetë mjeti kryesor për të adresuar nivelin e lartë të papunësisë (përmes krijimit të vendeve të reja të punës), të ulë deficitin e vazhdueshëm tregtar, të rrit zhvillimin e inovacionit në sektorin privat (përmes rritjes së shkathtësive së fuqisë punëtore, tërheqjes së investimeve të huaja dhe hulumtimeve shkencore) si dhe të ulë varësinë në remitenca (përmes gjenerimit të të ardhurave të brendshme). Mekanizmat e përfshirë në Fond janë paraqitur në kuadër të masave prioritare të SKZH-së.

Përmes instrumenteve të tij, Fondi do të mbështet sektorët e ekonomisë së Kosovës me potencial të lartë për rritje. Gjithashtu, do të inkurajoj zhvillimin në fusha të tjera të ekonomisë bazuar në nevojat dhe potencialin. Në përgjithësi fondin do të fokusohet në mbështetjen e sektorëve ekonomik me potencial të lartë eksportues dhe mundësisë për zëvendësimin e eksporteve, ku këta sektorë do të përcaktohen përmes zhvillimit të politikave industriale të Kosovës. Duke marr parasysh këtë, Qeveria synon të inkurajoj dhe mbështet zhvillimin industrial të bazuar në klaster (grupime), që është orientim qendror i qasjes së SKZH-së për promovimin e konkurrueshmërisë.

Fondi është parashikuar si një mekanizëm fleksibil, dhe strategjik, për të mundësuar mbështetje të koordinuar dhe të synuar drejt zbatimit të zotimeve të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim. Prandaj, me qëllim të zbatimit të prioritetëve të larta të SKZH-së, Qeveria do të themelojë Fondin për Zhvillim dhe Punësim duke bashkuar iniciativa të ndryshme të përkrahjes përmes buxhetit shtetëror dhe përkrahjes së partnerëve zhvillimorë.

Fillimisht Fondi, do të funksionoj si një mekanizëm i koordinuar duke ofruar mbështetje të synuar për sektorët prioritarë dhe llojet e aktiviteteve ekonomike përmes instrumenteve të tij të cilët do të përfshijnë fondin për garantimin e kredive, fondin për subvencionimin e pagave, skemën për investime strategjike, fondin për zhvillimin e sektorit të TIK, dhe mekanizmi për zhvillimin e konkurrueshmërisë së NVM-ve.

5) Fuqizimi i kapaciteteve

Me qëllim të përdorimit më të mirë të burimeve financiare, institucionet përgjegjëse për masat e SKZH-së duhet të vendosin në dispozicion sistemet më të mira menaxhuese dhe shkathtësi të nevojshme profesionale. Kjo kërkon **lidhje të fortë ndërmjet zbatimit të SKZH-së dhe procesit të Reformës së Administratës Publike**. Këshilli Ministror Qeveritar për RAP, i kryesuar nga Ministri i Administratës Publike është organ udhëheqës në këtë rast, që koordinon reformat në kuadër të tri shtyllave tematike të udhëhequra nga ZKM, MAP dhe MF.

Këshilli Ministror për RAP duhet të prioritetizoj masat dhe nën-masat që dalin nga Shtylla e II-të e SKZH-së (Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit), të cilat gjithashtu hyjnë në pakon e politikave për reformën e administratës publike (siç është paraqitur në tabelën më poshtë). Mundësimi i zbatimit të plotë të këtyre masave duke përfshirë institucionet dhe partnerët përkatës në punët e Këshillit, është thelbësore për zbatim të reformave të cilat janë të rëndësishme si për efikasitetin e administratës po ashtu edhe për ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Masat e SKZH-së për RAP	Përgjegjësia për zbatim	
	Udh. horizontale	Aplikimi sektorial
1 – Programi i thjeshtimit të mëtejshëm rregullator	ZKM (Zyra ligjore)	MTI +të tjerët
2 – Zhvillimi i analizave të ndikimit rregullator	ZKM (ZL dhe ZPS)	MTI +të tjerët
3 –Mbështetja e aranzhimit “one-stop shop”	MAP (njësia e re, +MAPL)	MTI +të tjerët
4 – Mbështetja e e-qeverisjes për shërbimet G2B	MAP (njësia e re & ASHI)	MTI +të tjerët
5 – Reformimi i administratës tatimore dhe doganës	MF (& agjencitë me të hyra)	MF, agj. me të hyra +të tjerë
6 – Plotësimi i boshllëqeve të sistemit të prokurimit dhe e- prokurimi	MF (APP, +KRrPP)	të gjithë operatorët

Gjithashtu, për masat e pakos së RAP që nuk janë përfshirë në SKZH, Këshilli Ministror për RAP duhet të sigurojë se veprimet dhe burimet për përmirësimin e sistemeve horizontale të menaxhimit (siç janë organizimi, personeli, zhvillimi i politikave, ofrimi i shërbimeve, menaxhimi financiar, etj.) zbatohen së pari në ato institucionet që janë përgjegjëse për zbatimin e prioriteteve të larta të përfshira në SKZH.

6) Monitorimi i progresit

Trajtimi i favorshëm i masave të SKZH-së duhet të garantohet përmes masave përkatëse të llogaridhënies, si rrjedhojë monitorimi periodik i saj duhet të bëhet **në kuadër të Planit ekzistues Vjetor të Punës së Qeverisë**. Sekretariati Koordinues i Qeverisë (SKQ) së bashku me ZPS është përgjegjës për monitorim të progresit të zbatimit të prioritetëve të SKZH-së ashtu siç është paraqitur në Planin Vjetor Punës së Qeverisë. Institucionet përgjegjëse pritet të raportojnë për progresin në baza tremujore brenda ciklit standard të planit të punës. ZPS, bazuar në kontributet e ministrive përgjegjëse që i dërgohen SKQ-së, analizon zbatimin e prioritetëve të larta dhe siguron raporte për Kryeministrin dhe Qeverinë. Raportet analitike për zbatimin e prioritetëve të larta të SKZH-së pas shqyrtimit në kuadër të Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik i paraqiten për informim dhe shqyrtim të mëtutjeshëm Komisionit për Planifikim Strategjik të drejtuar nga Kryeministri. Këto mekanizma duhet të sigurojnë adresimin e pengesave të mundshme që mund të jenë paraqitur për zbatimin e prioritetëve në kuadër të SKZH-së.

Gjatë këtij cikli, ZPS është përgjegjëse për të mbështetur Kryeministrin në arritjen e objektivave të SKZH-së duke i drejtuar përpjekjet drejt rezultateve të synuara dhe caqeve ekonomike. Në këtë kontekst, ZPS përcjellë punën e institucioneve të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e Udhërrëfyesit të SKZH-së dhe aranzhon rishikimet e rregullta të progresit për Kryeministrin. Gjithashtu, ZPS e mbështetë Kryeministrin në identifikimin e vështirësive që duhet të eliminohen përmes intervenimit politik, koordinimit më të mirë dhe masave financiare, menaxheriale apo stafit.

ZPS siguron të arrihen rezultate konkrete në monitorimin e aktivitetëve përmes informimit me kohë të publikut për progresin në arritjen e caqeve të SKZH-së, përmes dialogut me sektorin privat në kuadër të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik dhe shoqërinë civile në kuadër të platformës për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile.

7) Vlerësimi i rezultateve

ZPS duhet të sigurojë se SKZH vlerësohet plotësisht në intervale dy vjetore dhe vlerësim përfundimtar në vitin e fundit të zbatimit të saj. Vlerësimet do të fokusohen në atë shkallë që zbatimi i prioritetëve ka prodhuar rezultatet e dëshiruara, dhe ka arritur caqet e pritura për sa i përket treguesve të nivelit të lartë të SKZH-së. Vlerësimet po ashtu duhet të marrin parasysh burimet e alokuara për zbatimin e prioritetëve dhe koherencën e shpenzimit të tyre në raport me masat dhe objektivat e përcaktuara në SKZH.

ZPS do të paraqes në Qeveri një **metodologji gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme të vlerësimit**, zbatimi i së cilës mund t'i besohet rrjeteve të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë. Qeveria, në përputhshmëri me dialogun për politika me BE-në dhe institucionet ndërkombëtare financiare, mund të kërkoj apo të merr parasysh vlerësimet e pavarura të zbatimit të SKZH-së nga ana e organizatave ndërkombëtare që kanë reputacion dhe ekspertizë në fushat e mbuluar nga SKZH.

Konkludimet e vlerësimeve mund të përmbajnë propozime për ndryshime në objektivat dhe masat e SKZH-së, kornizën monitoruese dhe indikatorët si dhe burimet e alokuara për to. SKZH do të koordinojë rishikimin e raporteve të vlerësimit nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e SKZH-së dhe do t'i prezantojë të gjitha pikëpamjet para Komisionit për Planifikim Strategjik. Komisioni për Planifikim Strategjik në emër të Qeverisë publikon raportet e vlerësimit, fton publikun për komente dhe i përgjigjet përmes ndryshimeve në zbatim dhe prioritetet e SKZH-së sipas nevojës.